




Црвен крст на Република Македонија
Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë
Macedonian Red Cross

ГОДИШЕН ИЗВЕШТАЈ
RAPORTI VJETOR
ANNUAL REPORT

2014





Bëhuni vullnetar

Kryqi i kuq e mobilizon fuqinë e vullnetarëve që ta ndalojë dhe eliminojë vuajtjen e njerëzve gjatë situatave urgjente. Kryqi i kuq i juaj lokal ndoshta ofron mundësi edhe për trajnim që ndoshta ju nevojitet juve që të jeni të gatshëm gjatë katastrofave apo për organizimin e aksionit vullnetar për dhurimin e gjakut apo për dërgimin e porosive për ushtarët apo për lidhjen e familjeve të ndara si rezultat i konflikteve të armatosura. Vullnetarët e Kryqit të kuq i bashkon shërbimi dhe ndjenja e tyre se me atë që ndrojnë jetën e të tjerëve ndryshojnë edhe jetën e tyre.

A jeni të gatshëm për vullnetarizim?

VIZIONI I KRYQIT TË KUQ TË RM-së

Puna jonë e bazuar në parimet universale, ka fuqi ta përparojë botën në të cilën jetojmë nëpërmjet promovimit të paqes dhe tolerancës, preventivës efikase, përgjigjes në kohë dhe përkrahjes adekuate për popullatën e mjeruar.

MISIONI I KRYQIT TË KUQ TË RM-së

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonsië është organizatë humanitare, vullnetare e cila vepron në pajtim me parimet themelore të Lëvizjes ndërkombëtare dhe të Kryqit të Kuq dhe Gjysëmhnës së Kuqe, duke punuar në planin për sigurimin e ndihmës dhe shërbimeve për popullatën e mjeruar dhe promovimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe vlerave humane.

PËRMBAJTJA:

HYRJE	49
PROCESI I SERTIFIKIMIT PËR SHOQATË TË FUQSIHME NACIONALE	50
MBINDËRTIMI ORGANIZATIV I KAPACITETEVE TË SHOQATËS NACIONALE	54
MENAXHIMI ME VULLNETARË	56
BASHKËPUNIMI NË KUADËR NDËRKOMBËTAR	56
MOBILIZIMI I FONDEVE	58
MARËDHËNIE ME OPINIONIN	61
PËRGATITJE DHE VEPRIM GJATË KATASTROFAVE DHE GJATË GJENDJEVE NË KRIZË	62
SHËRBIMI PËR KËRKIM	66
VEPRIMTARI SHËNDETËSORE – PREVENIVE	67
NDIHMA E PARË	68
DHURIMI I GJAKUT	70
VEPRIMTARI SOCIALE – HUMANITARE	72
DISEMINIM	78
KOMITETI NACIONAL PËR DNH	78
PROGRAMI I KRYQIT TË KUQ NË AKSIONIN – PROMOVIMI I VLERAVE HUMANE (KKA – PVH)	79
AKTIVITETET E TË RINJVE	80
FALËNDERIM PËR VULLNETARËT, ANËTARËT E ORGANIZATËS, PARTNERËT DHE DONATORËT	82
RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2014	83

HYRJE

Jetojmë në një botë e cila është më e pasur se kur por njëkohësisht si kur deri tani me sfida dhe vështirësi të ndryshme për popullatën. Vitin që shkoi, si rezultat i ndryshimeve klimatike e shënuan katastrofat natyrore në rrethin tonë me pasoja të mëdha. Intensiteti i rritur i konflikteve lokale dhe mes shteteve në botë gjithashtu solli praninë e një numri të madh të emigrantëve në vend dhe rajon. Ndryshimet ekonomike gjithashtu sollën që organizata jonë të ndajë një pjesë të madhe të vëmendjes dhe orvatjeve për të siguruar ndihmë humanitare për kategoritë e ndryshme të grupeve të marginalizuara.

Puna jonë humanitare zhvillohej në rrethim ku një pjesë e popullatës ishte e shfaqur në shtypje dhe sfida të caktuara. U munduam me kapacitetet tona materiale dhe njerëzore dhe përkrahjen e partnerëve tanë, para se gjithash sektorin korporativ, shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe gjysmëhënës së kuqe, institucionet shtetërore dhe organizatat tjera ndërkombëtare të ballafaqohemi me më shumë sfida në orvatjet tona që të ndërtojmë shoqëri ku popullata e mjeruar është më e sigurt dhe i gëzon parakushtet esenciale për një jetë dinjitoze.

Por në punën tonë asnjëherë nuk e harruam komponentën zhvillimore. Vazhdimisht investuam në zhvillim dhe ndërtim të kapaciteteve tona dhe në përparimin e kompetencave dhe aftësive të të punësuarve dhe vullnetarëve tanë. Ishim bashkë me të rinjtë por edhe me popullatën më të moshuar. Rriteshin klubet e të rinjve por edhe klubet e më të rriturve të cilët dëshmuam dhe treguan se gjithmon mund të llogaritet tek ata. U kujdesëm për bashkëjetesën, solidaritetin dhe tolerancën mes veti. Treguam se jemi lider humanitar në përforcimin e bashkësive në gjendje krize dhe katastrofa duke iu ndihmuar njerëzve të kenë jetë më të sigurt dhe dinjitoze.

Orvatjet tona gjatë viteve të kaluara, që vazhdimisht të mësojmë, të ndërtohem dhe përsosemi, rezultuan me mirënjohjen më të lartë të Federatës ndërkombëtare që në tre vitet e kaluara zbatoi evaluimin dhe vlerësimin e punës së Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë për plotësimin e standardeve dhe kualitetit në punë dhe pastaj e ndau qertifikatën e parë për shoqëri të fuqishme nacionale të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë. Me këtë dëshmuam se Kryqi i kuq akoma paraqet burim të krenarisë nacionale në të gjitha bashkësitë në Republikën e Maqedonisë dhe si organizatë kujdesemi për vlerat elementare dhe parimet e humanitetit, tolerancës, bashkëjetesës, paanshmërisë.

Tekstet e këtij raporti i pasqyrojnë iniciativat dhe arritjet tona për uljen e rreziqeve dhe përgatitje gjatë katastrofave, ngritje të vetëdijes për ndryshimet klimatike, mbrojtje të mjedisit jetësor, aktivitetet sociale – humanitare për uljen e mjerueshmërisë të kategorive të ndryshme qëllimore si dhe programet dhe fushatat shëndetësore – preventive të shoqatës sonë nacionale për preventivën e sëmundjeve dhe jetë të shëndoshë, vlerat humane, ndërtimi i besimit dhe kuptimit reciprok, tolerancës dhe dialogut posaçërisht tek gjeneratat e reja dhe mes etnitetëve të ndryshme.

Ju ftojme në udhëtim humanitar nëpër faqet e raportit tonë vjetor ku do të njoftoheni me praktikimin tonë të shtatë parimeve humanitare të humanitetit, paanshmërisë, pavarësisë, shërbimit vullnetar, universalitetit dhe pjesës së vullnetarëve tanë me emër dhe pa emër.



D-r Millço Trajkov
Kryetar



D-r Sait Saiti
Sekretar gjeneral

PROCESI I SERTIFIKIMIT PËR SHOQATË TË FUQSIHME NACIONALE

Në periudhën tetor 2011 – mars 2014 Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë kaloi nëpër një proces të certifikimit të kapaciteteve organizative i cili u zbatua nga ana e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Qëllimi kryesor i procesit për vlerësim organizativ të kapaciteteve dhe certifikimit është që t'iu mundësohet shoqatave nacionale t'i vlerësojnë kapacitetet dhe punët e veta me qëllim që të vërtetohen qasjet më të mira për zhvillim të pavarur, si dhe të jepet vërtetim për ato shoqata nacionale të cilat kanë arritur nivel të lartë të kompetencës. Procesi për vlerësim organizativ të kapaciteteve dhe certifikimit është proces i kompleksuar i përbërë prej dy vlerësimeve të posaçme. Një është vetvlerësim, ndërsa tjetra vlerësim nga ekip i jashtëm për vlerësim. Të dy vlerësimet janë të shoqëruara me komplete gjithëpërfshirëse të intervenimeve organizative – zhvillimore, të cilat janë të thurrura të tregojnë në kapacitete specifike deficitare të cilat identifikohen gjatë vlerësimeve.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë me sukses e kaloi procesin e certifikimit. Më poshtë janë vendosur nxjerrje nga raporti përfundimtar i Federatës ndërkombëtare e cila i prezanton rezultatet e dy vlerësimeve të realizuara dhe rekomandimin për certifikimin e KKRMsë. Certifikata për shoqatë të fuqishme nacionale pritet që në mënyrë solemne t'i dorëzohet Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në kuvendin gjeneral të Federatës ndërkombëtare që do të mbahet në nëntor të vitit 2015.

RAPORTI INTEGRAL I EKIPIT TË JASHTËM PËR VLERËSIMIN E FEDERATËS

Sertifikimi i kapaciteteve organizative të shoqatave nacionale – Faza 1

Faza e parë e procesit të certifikimit (vetvlerësim) u realizua në Strugë, Maqedoni në periudhën prej 22 – 24 tetor të vitit 2011. Ekipi i Federatës ndërkombëtare vizitoi edhe 3 OKKK (Shkup, Ohër dhe Kumanovë). Sesiioni u fasilitua nga Roxher Brake dhe Inam Upah të njësisë për zhvillim organizativ të Federatës ndërkombëtare të Gjenevës. Qëllimi i Fazës 1 të certifikimit të kapaciteteve organizative të shoqatave nacionale ishte të vlerësohen kapacitetet dhe puna e KKRMsë që të vërtetohen qasjet më të mira për zhvillim personal. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë pozitivisht u vlerësua për të gjitha 88 atributet për sukses në punë që dëshmon se shoqata nacionale funksionon mirë me kulturë të mirë organizative dhe sisteme të brendshme të definuara mirë. Me këtë KKRMsë menjëherë i plotësoi kriteret për realizimin e Fazës 2 në Maqedoni.

Sertifikimi i kapaciteteve organizative të shoqatave nacionale – Faza 2

Vlerësimi i jashtëm u realizua në Shkup, Maqedoni në periudhën prej 8 – 10 mars të vitit 2014. Ekipi i jashtëm për vlerësim, i udhëhequr nga Roxher Brake, shef i Njësisë për zhvillimin e performansave të Federatës përbëhej prej 3 përfaqësuesve të Federatës ndërkombëtare, 2 përfaqësues të Kryqit të kuq të Slllovenisë dhe 2 përfaqësues të Kryqit të kuq të Gruzisë.

Qëllimi i vlerësimit të jashtëm ishte që të shqyrtohen elementet tjera përkaj kapaciteteve të shoqatës nacionale siç është funksionimi i shoqatës nacionale në kontekstin nacional. Ky vlerësim është i dizajnuar që të matet ndikimi i punës së shoqatës nacionale në 4 dimensione të ndryshme: **kohezion i brendshëm, zgjedhje relevante, kualitet optimal dhe vëllim optimal të shërbimeve** të cilat i siguron shoqata nacionale në vend.

Ekipi i jashtëm për vlerësim kaloi 3 ditë në shoqatën nacionale dhe pati mundësi të: shqyrtojë dhe diskutojë dëshmi të siguruara nga KKRMsë; vizita 2 partnerë udhëheqës korporativ në vend; realizojë takim me ministrin për punë dhe politikë sociale; realizojë takim të KK të qytetit të Shkupit; realizojë vizitë në Qendrën ditore për dhurim të gjakut; realizojë takim në Qendrën ditore për persona të moshuar; realizojë vizitë në Pikën për të pastrehur; realizojë vizitë në Qendrën për përkrahjen e kërkuesve të azilit; realizojë vizitë në KK Kriva Pallankë dhe u takua me përdoruesit e programit për kujdesin e personave të moshuar në kushte shtëpiake.

Kohezionii brendshëm i shoqatës nacionale është

i pranishëm në masë jashtzakonisht të madhe, së pari nga pikëpamja e raporteve të ngrohta dhe të ngushta në të gjitha nivelet të shoqatës nacionale, në nivel të udhëheqësisë, në nivel të drejtorisë, mes punëtorëve, vullnetarëve dhe të rinjve. Ekziston këmbim i liri dhe i lehtë dhe respektim i historisë dhe llojllojshmërisë multikulturore që ekziston në shoqërinë e Maqedonisë.

Kohezioni i dukshëm mbështetet në kulturën e fuqishme të ndarjes së thellë të vizionit të përbashkët në bazë të identitetit dhe ardhmërisë së shoqatës dhe investimit të vazhdueshëm në komunikimin e shkëlqyeshëm. Plani strategjik i KKRМ-së 2020 e integron misionin dhe vizionin, qëllimet dhe prioritetet strategjike, kapacitetet e kapshme dhe aktivitetet kyçe për plotësimin e qëllimeve të planifikuara. Të gjitha dokumentet sillen nëpërmjet debatit publik ku anëtarët dhe vullnetarët kanë mundësi t'i shprehin qëndrimet dhe mendimet e tyre. Dokumentet publikohen në tre gjuhë dhe ndahen me të gjithë partnerët dhe postohen në formë elektronike në ueb faqen e KKRМ-së. Edhe 11 OKKK kanë ueb faqet e veta. KKRМ-së gjithashtu boton gazetën javore elektronike që shpërndahet në 70.000 e-mail. Sekretari gjeneral thekson se suksesi pjesërisht në komunikimin e rregullt dhe të hapur në të gjitha nivelet e shoqatës nacionale si dhe me partnerët dhe opinionin.

Zgjedhja e KKRМ-së në shërbime relevante është komponentë tjetër e suksesit. Në pajtueshmëri me Ligjin për KKRМ-në, projektet janë të fokusuar në nevojat prioritare të popullatës së mjeruar me të cilat sigurohet përkrahje për nevoja kyçe në bashkësitë në bashkëpunim me pushtetet lokale dhe partnerët tjerë relevant. Identifikimi i nevojave bëhet nëpërmjet



vlerësimet sistematik të grupeve qëllimore. Kjo bëhet në mënyrë participative të përbërë nga përfaqësues të KCRM-së dhe partnerëve kyç në bazë të nevojave të vërtetuara në pajtueshmëri me anketat e realizuara në vend. Shembull i shkëlqyeshëm për suksesin e këtij procesi të selektimit mund të shihet në qendrat ditore për persona të moshuar dhe në pikën për të pastrehurit.

Si dëshmi e mëtutjeshme për punën e fuqishme relevante të KCRM-së në rrethin shoqëror është bashkëpunimi i fuqishëm me trupat e ndryshëm qeveritar. Në pajtueshmëri me Ligjin për KCRM-në, shoqata nacionale bashkëpunon me Qeverinë e RM-së dhe është anëtar i gjashtë trupave të ndryshëm qeveritar. Më shumë ministri por edhe vet kryeministri me krenari marrin pjesë në shoqatën nacionale që vetvetiu flet për pamjen e organizatës. Organizatat komunale të KCRM-së gjithashtu marrin pjesë në trupat e pushteteve lokale në nivel lokal. KCRM-së gjithashtu është anëtar në disa rrjete nacionale në sektorin qytetar që kanë për qëllim t'i koordinojnë aktivitetet në fusha të caktuara siç janë për shembull ndryshimet klimatike, HIV/SIDA dhe TB.

Kualitetin optimal të shërbimeve KCRM-së e siguron nëpërmjet qasjes së ndarë. Ekziston kulturë e fuqishme për monitoring dhe evaluim me çka bëhet shqyrtimi dhe evaluimi i programeve në nivel nacional dhe lokal në nivel vjetor. Bëhet revizion vjetor nga ana e Qendrës dhe OKKK. Të gjitha planet vjetore për punë realizohen dhe analizohen në pajtueshmëri me rezultatet e realizuara në vitin e kaluar dhe qëllimet e vërtetuara për vitin vijues. Rezultatet e punës i prezantohen opinionit. Përskaj kulturës për monitoring dhe evaluim të KCRM-së, shoqata nacionale e vëzhgon dhe kontrollon kualitetin e shërbimeve të veta nëpërmjet

testimit të rregullt të kënaqjes së përdoruesve të shërbimeve. Rezultatet kontrollohen nga ana e të punësuarve dhe vullnetarëve e gjithashtu janë edhe lëndë e revizionit të jashtëm.

Kualiteti i punës së KCRM-së gjithashtu është i shprehur në partneritetet e realizuara dhe në mirënjohjet e ndara. Dy prej liderëve udhëheqës në sektorin korporativ në Maqedoni (EVN dhe Alkaloid) shprehën kënaqësi dhe falënderim të thellë për bashkëpunimin me KCRM-në. Gjithashtu ministri për punë dhe politikë sociale theksoi se ata janë tepër të kënaqur që KCRM-së është partner i tyre për shkak se KCRM-së kënaq nevoja të rëndësishme për popullatën e mjeruar në shoqëri të cilat nuk i mbulon qeveria.

Vërtetim për kualitetin e punës së KCRM-së është edhe partneriteti shumëvjeçar me UNHCR-në dhe Fondin global. KCRM-së është partner me UNHCR-në më shumë se 10 vjet në sigurimin e kujdesit shëndetësor dhe përkrahjen logjistike për të ikurit dhe kërkuesit e azilit ndërsa me Fondin global është partner më shumë se 8 vjet në fushën e HIV/SIDA dhe TB në pjesën e sigurimit të kujdesit dhe preventivës. UNDP bashkëpunimin me KCRM e klasifikon si një prej 5 sukseseve në vitin 2010 nëpërmjet projektit për ngritjen e vetëdijes për përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave.

Në vitin 2012, KCRM-së është fitues i mirënjohjes vjetore për filantropi dhe përgjegjësi shoqërore të ndarë nga Qendra për Zhvillim Institucional. Dy vullnetarë të KCRM-së gjithashtu janë njohur si liderë humanitar në vend nga ana e Qeverisë së RM-së.

Përfundimisht, përcaktimi për **rritjen e vëllimit të shërbimeve** është evident në më shumë nivele nëpërmjet kontributit për identifikim dhe replikim të shërbimeve të suksesshme siç janë liderë në fushën

e përparimit të dhurimit të gjakut, sigurimit të trajnimeve nga ndihma e parë për kandidatët për vozitës, rol udhëheqës në fushën e shpëtimit në male dhe siguri në ujë.

Shërbime specifike siç janë ngritja e vetëdijes për vet – mbrojtje nga katastrofat janë të pranishme në të gjithë vendin, ndërsa gjatë kohës së valëve të ftohta dhe të nxehta vullnetarët e KCRM-së sigurojnë përkrahje esenciale nëpërmjet shpërndarjes së materialit informativ, ujë, strehim dhe pako humanitare.

KCRM-së gjithashtu organizon dhe implementon programe të mëdha nacionale. KCRM-së është aktor kyç në promovimin dhe organizimin e aksioneve për dhurimin e gjakut në vend janë grumbulluar 55.000 njësi gjaku (3% nga popullata) në nivel vjetor që qindpërqind i plotëson nevojat për gjak në vend.

KCRM-së është i njohur si organizatë udhëheqëse në vend në plan humanitar. Mbi 5000 organizata, fondacione dhe asociacione janë aktive në Maqedoni, por vetëm KCRM-së veçohet si partner primar i ministrive të Qeverisë.

KCRM-së gjithashtu është primar edhe në sektorin korporativ kur bëhet fjalë për implementimin e aktiviteteve për përgjegjësi shoqërore korporative. Kjo del si rezultat i raportit profesional ndaj obligimeve të ndara, qasjes participative në implementimin e shërbimeve dhe aktiviteteve, kënaqja e shfrytëzuesve dhe partnerëve.

Transparenca në punë dhe lajmërimi i mirë dhe imazhi i organizatës rezultoi me nënshkrimin e marrëveshjeve për bashkëpunim me KCRM-së me shumë ministri dhe institucione tjera shtetërore, vetqeverisje lokale të cilat paraqesin kornizë për punën e KCRM-së me partnerët.

KKRM-së gjithashtu është lider në vend në implementimin e programeve siç janë ndihma e parë për vozitës dhe është e vetmja organizatë në vend që ka trajnuar instruktorë dhe shpëtues për siguri në male dhe ujë.

KKRM-së e përdor metodologjinë e pilotimit të projekteve dhe programeve dhe replikimit të praktikave të suksesshme me çka sigurohet sukcesi dhe qëndrueshmëria e shërbimeve. Dy shembuj për këtë janë projekti për kujdesin e personave të moshuar në kushte shtëpiake që tani njihet dhe përkrahet edhe nga qeveria si dhe programi për ngritjen e vetëdijes tek rinia për rreziqe nga katastrofat. Projekti i dytë njihet nga UNDP-ja dhe rangohet mes 5 më të mirëve në botë.

REKOMANDIMI EKIPIT TË JASHTËM PËR VLERËSIM

Pas shqyrtimit të përgjithshëm të dëshmive të dorëzuara nga ana e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, Ekipi i jashtëm për Vlerësim i rekomandon Komitetit për Pajtueshmëri dhe Ndërmjetësim të Federatës ndërkombëtare që ta shpallë Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë për shoqatë të parë nacionale të certifikuar me notë “për shembull”.



MBINDËRTIMI ORGANIZATIV I KAPACITETEVE TË SHOQATËS NACIONALE

Përcaktimet zhvillimore të shoqatës nacionale në vitin 2014 ishin të drejtuara kah përmirësimi i imazhit të shoqatës nacionale në vend dhe në kuadër të Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe si dhe kah përparimi i kualitetit të shërbimeve për kategori të ndryshme të shfrytëzuesve të shërbimeve dhe mbindërtimi i kapaciteteve të pjesëve integrale të shoqatës nacionale. Aktivitetet kyçe në vitin 2014 ishin drejtuar kah rrrumbullakësimi i procesit të sertifikimit të KKRМ-së për shoqatë të fuqishme nacionale, trajnim dhe mbindërtim të kapaciteteve të resurseve njerëzore dhe përparimi i bashkëpunimit partneror të KK në vend dhe jashtë vendit.

Punëtori për trajnimin e shërbimit për përgatitje gjatë katastrofave. Në kuadër të aktiviteteve për mbindërtimin e kapaciteteve të shërbimit profesional të KKRМ-së u organizua punëtori për përgatitje gjatë katastrofave. Punëtorja u mbajt në periudhën prej 24 deri më 26 prill të vitit 2014 në Strugë në qendrën për trajnim dhe rekreacion të KKRМ-së. Gjatë trajnimit shërbimi u njoftua me më shumë përmbajtje lidhur me ndërtimin e kapaciteteve dhe përgatitje në rast të katastrofave natyrore.

Takim koordinues me sekretarë të OKKK dhe KKQSH. Në periudhën prej 20 deri më 21 qershor të vitit 2014 Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë organizoi takim pune me sekretarët e organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Takimi koordinues u shfrytëzua për prezantimin e më shumë përmbajtjeve lidhur me punën e shoqatës nacionale siç është mobilizimi i fondeve, puna projektuese, procedurat financiare dhe administrative, standardet për menaxhim të mirë, zhvillim





të ndihmës së parë dhe dhurimit të gjakut, sfidat financiare dhe gjendjet tjera aktuale në punën e OKKK. Sekretarët e OKKK gjithashtu i prezantuan sfidat e ndryshme me të cilat ballafaqohen gjatë punës së përditshme në mjediset e tyre lokale si dhe për prioritetet vijuese të organizatave komunale të Kryqit të kuq të cilat dalin nga ana e sfidave ekzistuese.

Seminar për planifikimin e projekteve dhe programeve. Në periudhën prej 22 deri më 24 gusht Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë mbajti punëtori për planifikimin e projekteve dhe programeve në kuadër të implementimit të projektit IPA për kujdesin e personave të moshuar që implementohet në komunat Kërçovë, Prilep dhe Gostivar. Punëtorja u mbajt në Strugë në qendrën për trajnim dhe rekreacion të KKRМ-së. Qëllimi i punëtorisë ishte përmirësimi i kapaciteteve për planifikimin e projekteve dhe programeve në organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe organizatave komunale të këtyre 3 komunave të cilat janë pjesë e aktiviteteve projektuese. Trajnimi përfshin nga dy përfaqësues të 11 organizatave të sektorit qytetar të këtyre 3 komunave dhe nga dy përfaqësues të OKKK Manastir dhe OKKK Strugë.

Takim koordinues me kryetarë të OKKK. Në kuadër të aktiviteteve për mbindërtimin e kapaciteteve dhe sigurimin e koordinimit efektiv të strukturës udhëheqëse të shoqatës nacionale, u mbajt takim pune për kryetarët e organizatave komunale të Kryqit të kuq / Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Takimi koordinues u mbajt më 20 shtator të vitit 2014 në Kumanovë. Në këtë takim morën pjesë kryetarë të 19 organizatave komunale dhe u diskutuan më shumë tema mes cilave analiza e punës së kryetarëve të OKKK në vitin e dytë mandatar; analiza e vizitave evaluuese të realizuara për vëzhgimin e punës së OKKK dhe KK të qytetit të Shkupit; futje e mjetit për evaluim në punën e sekretarëve të OKKK dhe KK të qytetit të Shkupit dhe rregullore për metodologjinë për përcaktimin e numrit të vendeve të punës dhe për llogaritjen e rrogave të sekretarëve dhe të punësuarve në OKKK të Republikës së Maqedonisë.

Takim koordinativ me sekretarë të OKKK. Në kuadër të aktiviteteve të rregullta për mbindërtimin e kapaciteteve të OKKK u mbajt mbledhje me sekretarë të OKKK/KKQSH më 26.09.2014 në Shkup ku morën pjesë sekretarë të 32 OKKK dhe KKQSH. Në këtë mbledhje u diskutuan më shumë tema: analiza e vizitave evaluuese të realizuara për vëzhgimin e punës së organizatave komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit, çështje aktuale në sferën e dhurimit të gjakut, ndihma e parë, rinia, KKA – PVH, përgatitje dhe veprim gjatë katastrofave, veprimtari sociale humanitare, përgatitje e planit operativ për punën e vitit 2015, përgatitje e rregullores për metodologjinë e përcaktimit për përcaktimin e numrit të vendeve të punës dhe për llogaritjen e rrogave të sekretarëve dhe të punësuarve në organizatën e KKRМ-së dhe futje e mjetit për evaluimin e punës së sekretarëve të OKKK dhe KK të qytetit të Shkupit.

Seminar për menaxhim vullnetar. Në periudhën prej 28 deri më 30 nëntor, Kryqi i kuq i RM-së mbajti punëtori për menaxhim vullnetar në kuadër të implementimit të projektit IPA për kujdesin e personave të moshuar që implementohet në komunat Kërçovë, Prilep dhe Gostivar. Punëtorja u mbajt në Strugë në qendrën për trajnim dhe rekreacion të KKRМ-së.

Qëllimi i punëtorisë ishte përmirësimi i kapaciteteve për tërheqjen e vullnetarëve në organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe organizatave komunale të këtyre 3 komunave që janë pjesë e aktiviteteve projektuese.

MENAXHIMI ME VULLNETARË

Tregimi vullnetar në Kryqin e kuq

Përkrahja dhe zhvillimi i vullnetarizimit paraqet parakusht për të gjitha aktivitetet programore që i implementon Kryqi i kuq i RM-së. Prej këtu del edhe angazhimi i vazhdueshëm për mbindërtimin e kapaciteteve për menaxhim të suksesshëm të programeve vullnetare si prioritet në aktivitetet e shoqatës nacionale. Në vitin 2014 janë organizuar më shumë trajnime për personat përgjegjës për organizimin e punës vullnetare, liderët e klubeve të rinjve dhe janë zgjedhur përfaqësues të organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit për vlerësim të suksesshëm, rekrutim, organizim, motivim dhe koordinim të vullnetarëve në aktivitetet e Kryqit të kuq.

Për promovimin e ndikimit të Kryqit të kuq të RM-së realizoi sellfi fushatë nëpër rrjetet sociale me personalitete të njohur të cilët e ndanë tregimin e tyre në Kryqin e kuq në drejtim të nxitjes së opinionit për përkrahje aktive të aktiviteve humanitare të cilat i organizon Kryqi i kuq.

Më 5 dhjetor "Dita botërore e vullnetarizimit" Kryqi i kuq i RM-së ndau mirënjohje për: Vasill Apostollov, Vait Mustafa dhe Dimitar Karakulev, për merita të veçanta në realizimin e qëllimeve dhe detyrave të shoqatës nacionale dhe për aktivitetet e veta shumë vjeçare si vullnetarë, si dhe për OKKK Çair për shumë orë vullnetare të realizuara në kuadër të programit

KKA-PVH për ciklin 2013/2014 dhe Qendrën ditore për persona të moshuar dhe qendrën për dhënie e ndihmës në kushte shtëpiake. Gjatë manifestimit u ndanë edhe shpërblime – fotoaparate për fotografinë më të mirë nga aktivitetet e Kryqit të kuq për OKKK Ohër dhe për Sellfi fushatë më mirë të realizuar për OKKK Karposh.



BASHKËPUNIMI NË KUADËR NDËRKOMBËTAR

Gjatë vitit 2014 Kryqi i kuq i RM-së realizoi më shumë aktivitete në plan ndërkombëtar drejtuar kah sigurimi i mjeteve programore dhe projektuese për mbindërtimin e kapaciteteve të veta, ndarje të përvojave dhe njohurive pozitive dhe përparimi i bashkëpunimit bilateral me shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe me organizata dhe agjenci tjera ndërkombëtare. Përfaqësues të shoqatës nacionale morën pjesë në më shumë konferenca ndërkombëtare, seminare, mbledhje, trajnime dhe kampe për të rinj. Aktivitetet ndërkombëtare sipas veprimtarive janë pjesë integrale e këtij raporti.

Certifikatë për KCRM-së për shoqatë të fuqishme nacionale. Faza e dytë e procesit të qertivikimit u realizua në Maqedoni në periudhën prej 4 deri më 8 mars të vitit 2014. Vlerësimin e realizoi ekip i jashtëm për vlerësim i përbërë prej 3 përfaqësuesve të Sekretariatit të Federatës ndërkombëtare dhe nga dy përfaqësues të KK të Sllovenisë dhe KK të Gruzisë. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë me sukses u përgjigj në këtë sfidë dhe mori notën më të lartë për kualitet dhe punë në shoqatën nacionale. Ekipi i jashtëm për vlerësim dha notat më të larta për punën e Kryqit të kuq të RM-së në të gjitha katër dimensionet të cilat ishin lëndë e vlerësimit.

Vizitë bilaterale e delegacionit të Kryqit të kuq të Kosovës. Më 15 maj të vitit 2014 Kryqi i kuq i Repub-

likës së Maqedonisë u vizitua nga ana e 4 delegatëve të Kryqit të kuq të Kosovës udhëhequr nga kryetari i organizatës Adem Nura dhe sekretari gjeneral Feride Hyseni. Gjatë vizitës njëditore delegacioni i KK të Kosovës u prit nga kryetari i Kryqit të kuq të RM-së d-r Millço Trajkov dhe nga sekretari gjeneral d-r Sait Saiti me çka u këmbyen përvojat rreth funksionimit dhe zhvillimit institucional të dy organizatave. Mysafirët e vizituan edhe KK të qytetit të Shkupit, Qendrën ditore për dhurimin e gjakut dhe Qendrën ditore për persona të moshuar në Dare Xhambaz – Shkup.

Konferenca e 9-të evropiane e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Në periudhën prej 4 – 6 qershor të vitit 2014 në Firencë, Itali u mbajt Konferenca e 9-të evropiane e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Në këtë Konferencë morën pjesë 53 shoqata nacionale të KK dhe GJHK, Federata ndërkombëtare dhe Komiteti ndërkombëtar të KK. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë u prezantua nga ana e kryetarit të organizatës d-r Millço Trajkov. Temat kryesore në Konferencë ishin vullnetarizimi në Lëvizje, migrimet, siguri në ushqim, puna e shoqatave nacionale në gjendje krize, varfëria dhe pasojat e krizës ekonomike. Gjatë Konferencës, aktivitetet e Kryqit të kuq të RM-së u prezantuan në dy punëtori. Kryetari Trajkov gjithashtu kishte edhe paraqitje hyrëse në punëtori: “Si munden partnerët e Kryqit të kuq të ndihmojnë në eliminimin e problemit me drogën”.

Përparimi i bashkëpunimit bilateral mes Kryqit të kuq të Maqedonisë dhe Kryqit të kuq të Sllovenisë. Në periudhën prej 03 – 07 shtator të vitit 2014 delegacioni i shërbimit profesional të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë realizoi takim në Kryqin e kuq të Sllovenisë. Gjatë qëndrimit u vizitua Qendra

e Kryqit të kuq të Sllovenisë, organizatat komunale të Kryqit të kuq Novo Mesto dhe Kryqi i kuq Kopar dhe Qendra për rekreacion dhe shërim në Debeli Rtiç, Ankaran. U realizuan më shumë takime pune me sekretarin gjeneral z. Danijell Starman dhe shërbimi profesional i Kryqit të kuq të Sllovenisë ku u bë fjalë për përparimin e bashkëpunimit bilateral në nivel nacional dhe lokale në veprimtaritë e ndryshme programore të Kryqit të kuq dhe implementimi i projekteve partnerore nëpërmjet fondeve të BE.

Bashkëpunimi bilateral me Kryqin e kuq të Bullgarisë. Në periudhën prej 09.09.2014 – 10.09.2014 përfaqësues të Kryqit të kuq të RM-së e vizituan Kryqin e kuq të Bullgarisë me qëllim që të njihen me gjendjen dhe nevojat e popullatës së goditur nga përmbytjet që e kapluan Republikën e Bullgarisë në këtë periudhë. Nga ana e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë u ofrua ndihmë humanitare për menaxhim me sfidat dhe nevojat e popullatës.

Takim me përfaqësuesit e ekipit multi – agjencional të Komandës evropiane të SHBA. Më 29 tetor u mbajt takim pune me përfaqësuesit e Kryqit të kuq të RM-së dhe ekipin agjencional të Komandës evropiane të SHBA ku u diskutuan më shumë çështje lidhur me aktivitetet e Kryqit të kuq të RM-së në sferën e përgatitjes për menaxhim me pasojat e katastrofave dhe bashkëpunim me agjencitë shtetërore të RM-së të cilat veprojnë në këtë fushë.

Mbledhje lidere regjionale e Federatës ndërkombëtare. Delegacion prej dy anëtarëve udhëhequr nga sekretari gjeneral d-r Sait Saiti mori pjesë në mbledhjen lidere regjionale që u mbajt në Budapest Hungari në periudhën prej 4-5 nëntor të vitit 2014. Në këtë mbledhje u diskutuan propozim ndryshimet e



kushtetutës së Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe implementimi i përmbylljeve të Konferencës evropiane – Thirrja për Aksion nga Firenca. Gjithashtu u diskutua Rezoluta e Iniciativës për brendim dhe doracak i Federatës për përdorimin e ëmblemave dhe logove të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në komunikimet, marketingu dhe mobilizimi i fondeve. Një ndër temat kryesore ishte edhe përmirësimi i mekanizmave për komunikim dhe bashkëpunim në Lëvizje.

MOBILIZIMI I FONDEVE

Kontribut në nxitjen e përgjegjësisë shoqërore në sektorin korporativ

Bashkëpunim partneror. Një ndër qëllimet strategjike të Kryqit të kuq të RM-së për mobilizimin e fondeve të sektorit korporativ është zbatimi i bashkëpunimit partneror dhe përkrahja e kompanive në Maqedoni. Kryqi i kuq i RM-së gjatë vitit realizoi bashkëpunim të frytshëm me kompani të mëdha dhe të rëndësishme të cilat në biznesin e tyre e praktikojnë edhe përgjegjësinë shoqërore. Këto kompani siguruan përkrahje të rëndësishme me të cilën Kryqi i kuq implementoi aktivitete të shumta projektuese nëpërmjet organizatave komunale të Kryqit të kuq me çka u përfshinë grupet e mjeruara qëllimore të popullatës.

Kryqi i kuq i RM-së është lider i njohur në vend që jep kontribut të madh në nxitjen e përgjegjësive shoqërore të kompanive për angazhimin e tyre në kualitetin e jetesës së popullatës në shoqëri. Kryqi i kuq shënon interes të madh për realizimin e aktiviteteve projektuese nga ana e të punësuarve në kompanitë me të cilat është realizuar bashkëpunim afatgjatë. I madh është interesimi i kompanive edhe për vullnetarizim të të punësuarve të tyre në aktivitetet e Kryqit

të kuq. Zhvillimi i këtij lloji të bashkëpunimit është sfidë e madhe e Kryqit të kuq në periudhën që vijon. Në këtë mënyrë përforcohet besimi i kompanive ndaj Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë si partner i vërtetë për bashkëpunim.

Gjatë vitit 2014 u realizua bashkëpunim me 12 kompani të mëdha, si dhe një numër i madh i kompanive të mesme dhe të vogla në vend. Përkrahja e kompanive të mëdha për implementimin e projekteve dhe aktiviteteve programore të Kryqit të kuq të RM-së është në vlerë të përgjithshme prej 6.500.000 denarë që paraqet kontribut të rëndësishëm në realizimin e qëllimeve humanitare të organizatës.

Mbindërtimi i kapaciteteve. Në kuadër të Projektit “Kujdes për persona të moshuar në bashkësi”, financuar nga Bashkimi evropian, që implementohet nëpërmjet organizatave komunale të Kryqit të kuq Prilep, Gostivar dhe Kërçovë në bashkëpunim me 11 shoqata qytetare, prej 20 deri më 22 tetor të vitit 2014. Kryqi i kuq i RM-së organizoi punëtori për mobilizimin e resurseve për programe sociale. Pjesëmarrësit e punëtorisë kishin mundësi të përcjellin praktika pozitive të Kryqit të kuq të Austrisë për mobilizimin e resurseve në Austri. Me trajnimin u përfshinë gjithsej 28 përfaqësues të Kryqit të kuq dhe shoqatave qytetare të cilat u hasën me aftësi dhe dituri të caktuara për mobilizimin e resurseve nga individë dhe kompani për përkrahjen e programeve sociale dedikuar për të ndihmuar dhe u kujdesur për personat e moshuar.

Mbledhje partnerore. Më 16 maj të vitit 2014 në





KOMPANI

Bashkëpunim i realizuar dhe përkrahje e aktiviteteve

EVN MAQEDONI SHA

Përkrahje e Projektit kujdes për persona të moshuar në kushte shtëpiake që implementohet nëpërmjet Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatave komunale të KK Veles, Kriva Pallankë, Kërçovë dhe Dibër, me çka janë përfshirë gjithsej 240 persona të moshuar.

Është implementuar aksioni i përbashkët humanitar "Të ndajmë lumturi" – janë ndarë dhurata për vitin e ri (çanta dhe çokollata) për 680 fëmijë me nevoja të posaçme dhe fëmijë të familjeve të rrezikuara sociale në shtatë komuna në vend.

Banka Komerciale SHA Shkup

Përkrahje e Projektit për përmirësimin e socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të posaçme (340 fëmijë) implementuar nëpërmjet shtatë organizatave komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit

ALFA Banka SHA Shkup

Përkrahje e aktiviteteve projektuese për menaxhim me rroba të përdorura – është hapur Pikë për rroba në Shkup.

Stopnaska Banka SHA Shkup

Përkrahje në sigurimin e 506 pakove me ushqim dhe mjete për higjienë për të ndihmuar familjet në rrezik social, janë ndarë në mbi shtatë organizata komunale të KKRM-së.

ALIJANS UAN MAQEDONI, Kavadar

Përkrahje e projektit Përparim i pozitës së personave me invaliditet trupor, që implementohet nëpërmjet Organizatës komunale të Kryqit të kuq Viniçë.

KOMFI ANGEL, Prilep

Ndihmë e siguruar në 10.000 jorganë për fëmijë të dhuruar në çerdhe për fëmijë dhe njësi të fëmijëve në spitale në të gjithë vendin

KNAUF

Janë siguruar materiale në aksion "Zgjhuni human – së bashku deri në shtëpi"

PANAIRI I SHKUPIT

Është siguruar përkrahje në hapësirë në organizimin e manifestimeve të Kryqit të Kuq të RM-së

MAKPROGRES, Viniçë

Është organizuar fushatë për sigurimin e mjeteve nëpërmjet shitjes së prodhimeve Viniçini, dedikuar për implementimin e Aktiviteteve projektuese për përmirësimin e socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të posaçme në katër komuna.

FONDACIONI T-MOBILE për Maqedoni

Numër i siguruar pa pagesë për donacione

ONE

Numër i siguruar pa pagesë për donacione

VIP

Numër i siguruar pa pagesë për donacione

Panairin e Shkupit, u mbajt Mbledhja e pestë partnerore në organizim të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë. Mbulues i këtij manifestimi ishte EVN Maqedoni, kompania me të cilën Kryqi i kuq realizon bashkëpunim partneror afatgjatë. Qëllimi i mbledhjes partnerore ishte të promovohen vlerat humanitare dhe kapacitetet e Kryqit të kuq të RM-së për nxitjen e partneriteteve strategjike për implementimin e programeve të përbashkëta të dobishme shoqërore për përmirësimin e kualitetit të jetesës së popullatës së mjeruar. Në mbledhjen partnerore morën pjesë përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe agjencive në vend, përfaqësues të ambasadave të Austrisë, Francës dhe Sllovenisë në RM-së, odat ekonomike, si dhe përfaqësues të sektorit korporativ në Republikën e Maqedonisë. Përkaj kësaj u promovua edhe publikimi "Praktika dhe iniciativa për bashkëpunim partneror" që u botua me përkrahjen e EVN Maqedoni, ku janë përmbajtur disa shembuj të praktikave pozitive, si dhe iniciativa projektuese për bashkëpunim partneror.

Më 26 qershor të vitit 2014 Kryqi i kuq i RM-së në bashkëpunim me Odën ekonomike të Amerikës e organizoi mbledhjen e 6-të partnerore ku morën pjesë kompani, anëtarë të odës. Në këtë mbledhje u prezantuan praktika pozitive të bashkëpunimit partneror nga ana e përfaqësuesve të disa kompanive me të cilat Kryqi i kuq ka realizuar bashkëpunim të frytshëm dhe përkrahje në aktivitetet projektuese. Në këtë mbledhje përfaqësuesit e kompanive e theksuan nevojën për organizimin e trajnimeve për të punësuarit në kompanitë në fushën e përgjegjësive dhe vullnetarizimit shoqëror. Gjithashtu u dhanë propozime për bashkëpunim të ardhshëm partneror.

Mirënjohje të ndara "Përkrahësi i argjent" dhe "Përkrahësi bronzë". Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë më 11 dhjetor të vitit 2014 organizoi manifestim ku u ndanë mirënjohje "Përkrahësi i argjent" dhe "Përkrahësi bronzë" në shenjë falënderimi për partnerët dhe përkrahësit për bashkëpunimin e frytshëm dhe përkrahjen e realizuar. Në këtë manifestim në emër të Ministrisë për ekonomi të RM-së mbajti fjalim shefi i kabinetit z. Avni Kallaba, i cili e potencoi rolin e rëndësishëm të Kryqit të kuq në përparimin e përgjegjësive shoqërore tek ndërmarjet. Në shenjë falënderimi për përkrahjen të cilën e sigurojnë partnerët tanë për implementimin e projekteve shoqërore sociale dhe aktiviteteve humanitare, KKRМ-së u ndau mirënjohje "Përkrahësi i argjent" kompanive Alfa Banka SHA Shkup dhe Komfi Angel Prilep "Përkrahës bronzë" të Fershped SHA Shkup dhe Posta e Maqedonisë dhe falënderim Grupacionit ERA Panairi i Shkupit.





MARËDHËNIE ME OPINIONIN

Transparentë dhe llogaridhënës para opinionit

Duke ditur nevojën për informim të rregullt dhe në kohë, KCRM-së së bashku me organizatat e veta komunale theksi veçant i vëndua në transparencën dhe llogaridhënien e vazhdueshme para opinionit dhe partnerëve. Në vitin 2014 informimi dhe komunikimi i rregullt kontribuan për përparimin e sistemit për komunikim dhe informim dhe zbatim të bashkëpunimit më të afërt mes KCRM-së dhe mjeteve për informim publik. Në kuadër të sistemit informativ, KCRM-së gjithashtu siguronte informim më të gjerë të opinionit me qëllim lajmërimin e vazhdueshëm të qytetarëve për aktivitetet tona. Komunikimi i jashtëm u realizua nëpërmjet kumtesave dhe informacioneve në mediat elektronike dhe atë të shtypit, nëpërmjet konferencave të organizuara për shtyp dhe botimin e më shumë botimeve të shtypura informative të shoqatës nacionale.

Ueb faqja dhe rrjetet sociale të KCRM-së dhe OKKK.

Ridizajnimi dhe mbindërtimi i ueb faqes së KCRM-së mundësoi hapësirë për shpalljen e një numri më të madh të informacioneve të ndryshme, struktura e së cilës ka për qëllim kategori të ndryshme të vizitorëve. Pasurimi i tillë i ueb faqes me përmbajtje interaktive kontriboi që të tërhiqet vëmendja e opinionit të gjerë. Vullnetarët dhe qytetarët e vizitojnë ueb faqen

me qëllim që të vijnë në informacione për manifestime, vende për donacion dhe mënyra për kyçje në aktivitetet e organizatës.

E-gazeta. Botimet javore të gazetës zyrtare të Kryqit të kuq, tani më në mënyrë tradicionale japin shembull për mjet të suksesshëm për informimin e vullnetarëve tanë, partnerëve, bashkëpunëtorëve dhe përkrahësve për aktivitetet të cilat i realizojmë në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar. Në vitin 2014 u përgatitën 66 numra të e-gazetës së KCRM-së me gjithsej 650 tekste të shpallura. Përskaaj dërgimit të 70.134 e-mail adresa, i njëjti është azhuruar rregullisht dhe i shpallur në ueb faqe me çka i tërë opinionin i Republikës së Maqedonisë ka mundësi që prej së afërmi të njihet me aktivitetet tona.

Publikime. Javët tradicionale të defnuara në Ligjin për Kryqin e kuq, si dhe një numër i madh i aktiviteteve projektuese dhe dokumenteve strategjike në kuadër të veprimtarisë botuese të Shoqatës nacionale edhe këtë vit rregullisht u plotësuan me materiale kreative dhe edukative në formë të broshurave, fletushkave, postereve, doracakëve, pullave me pagesë dhe formë tjetër të borimit. Duke i pasur në vete porositë humanitare dhe drejtimet për veprim, u arritën rezultate të rëndësishme tek grupet qëllimore, e njëkohësisht edhe pozitivisht u ndikua në ngritjen e imazhit të shoqatës nacionale. Me qëllim që të gjitha publikimet të jenë më afër njerëzve për të cilat janë dedikuar, edhe këtë vit KCRM-së të gjitha botimet e veta i botoi në gjuhën maqedone dhe shqipe, ndërsa një pjesë prej tyre u përkthyen edhe në gjuhën angleze.

PËRGATITJE DHE VEPRIM GJATË KATASTROFAVE DHE GJATË GJENDJEVE NË KRIZË

Sigurimi i manifestimit fetar Ujrat e shenjta. Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit mori pjesë në sigurimin e manifestimit të madh fetar Ujrat e shenjta që çdo vit mbahet më 19 janar me rastin e festës Ujrat e shenjta. Pjesëmarrja me shpëtimtarët në ujë dhe ekipet për ndihmë të parë mjekësore këtë vit u rrit me pjesëmarrje plotësuese të ekipit logjistik i cili vendosi tendë – qendër për pranim dhe kuzhina mobiluese ku u përgatit çaj i cili iu ndahej pjesëmarrësve në këtë manifestim dhe njerëzve të cilët e ndiqnin manifestimin. U shpërnda edhe fletushka “Mbroeni veten gjatë kohës së ftohtë”.

Forumi nacional për adaptim në ndryshimet klimatike. Është koordinuar puna e forumit nacional për adaptim në ndryshime klimatike në drejtim të përgatitjes së studimeve në rast dhe përgatitje të raportit regjional për Forum të Evropës Jug – Lindore për adaptim në ndryshimet klimatike. Janë përgatitur dhe ndarë broshura edukative për sistemin klimatik, klimë dhe ndryshime klimatike. Janë ndarë broshura edukative për mbrojtje dhe vetmbrojtje si dhe rekomandime për sjellje gjatë valëve të ftohta.

Sigurim në kushte dimërore. Në bashkëpunim me më shumë shoqata alpiniste është organizuar edhe shënimi i Ditës ndërkombëtare e sigurisë në male – 15 janar me marshe tradicionale në rrugën kah manastiri Sh. Gjorgji në Vallandovë dhe manastiri Treskavec në Prilep.

Edukimi i të punësuarve në Fabrikën e cementit USJE. Në muajin shkurt, me kërkesë të fabrikës së cementit USJE, Shkup u mbajt punëtori për mbrojtje dhe vetmbrojtje nga katastrofat për të punësuarit në këtë kompani. Ligjërata u adaptua në pajtueshmëri me nevojat e kompanisë dhe në të morën pjesë 40 persona. Pjesëmarrësit u njoftuan me katastrofat dhe masat të cilat duhet t’i ndërmarin para, gjatë kohës dhe pas ndodhjes së katastrofës.

Ora e Planetit Tokë. Gjatë muajit mars në fushën e ndryshimeve klimatike, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë nëpërmjet organizatave të veta komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit në mënyrë aktive u kyç në aksionin botëror “Ora e Planetit Tokë”, me çkyqjen e dritave në kohëzgjatje prej një ore për paraqitje simbolike të nevojës për mbrojtje të mjedisit jetësor. Vullnetarët e klubeve të të rinjve organizuan aktivitete me të cilat u kyçën në këtë iniciativë në bashkëpunim me vetqeverisjet lokale.

Sistem informativ për zjarre në pyje. Përfaqësues të Kryqit të kuq të Maqedonisë, morën pjesë në prezantimin e “Sistemi informativ i Maqedonisë për zjarre në pyje – versioni 2” dhe promovimi i tij, si mjet në kuadër të sistemit nacional për preventivë dhe menaxhim me rrezikun zjarret në pyje në Republikën e Maqedonisë. Ngjarja u mbajt më 16.04.2014 në Shkup, në organizim të Qendrës për menaxhim me kriza.

Trajnim për të punësuarit në Kryqin e kuq. Në periudhën prej 26/27.04.2014 në Strugë, u mbajt trajnim për mbrojtje dhe vetmbrojtje për 20 të punësuar në KKRm-së, me çka u implementua rregullativa ligjore për siguri dhe shëndet gjatë punës.



Përkrahje për popullatën e përmbytur në Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë

Në muajin Maj Republika e Serbisë dhe Bosnja dhe Hercegovina u përfshinë nga fatkeqësia elementare që solli derdhjen e lumenjve nga koritat e tyre, dëme në penda dhe nxitën pasoja të shumta në infrastrukturë, në bujqësi dhe shtëpitë e banorëve në disa rajone të Serbisë dhe Bosnjes e Hercegovinës. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë menjëherë pas katastrofës natyrore realizoi kontakt me Kryqin e Kuq të Serbisë dhe Kryqin e kuq të B dhe H dhe ambasadat e Republikës së Serbisë dhe Republikës së B dhe H në Republikën e Maqedonisë dhe në pajtueshmëri me resurset materiale njerëzore ofroi ndihmë në ekipe dhe pajisje për shpëtim (anije gome, shpëtues në ujë , ekip për vlerësim për nevojat humanitare të popullatës dhe ekip me stacion mobil për pastrimin e ujit).

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë dërgoi apel tek qytetarët e Republikës së Maqedonisë, sektorin korporativ, institucionet, shoqatat qytetare dhe mediat për organizimin e aksioneve humanitare për grumbullimin e ndihmës për popullatën e mjeruar në Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kroaci.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë me të punësuarit e vet dhe vullnetarët si dhe me përkrahje të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në të gjithë periudhën me sukses u ballafaqua me sfidën që ta grumbullojë, paketojë dhe dërgojë ndihmën humanitare për popullatën e mjeruar në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë. Ndihma përbëhet nga ushqimi, mjete



për higjienë, ujë, lëngje, llopata, krevatë për fëmijë, pompa për ujë etj., që janë siguruar nga donacione individuale të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, donacione nga firmat dhe kompanitë dhe rezervat e KKRМ-së. Përkrahje logjistike për transport të ndihmës humanitare siguroi Qeveria e Republikës së Maqedonisë nëpërmjet kompanive për transport në RM.

Kryqi i kuq i RM-së nëpërmjet KK të qytetit të Shkupit dhe organizatave komunale të KK e realizoi operacionin humanitar për sigurimin e ndihmës për popullatën e mjeruar me 1190 vullnetarë të cilët ishin të angazhuar ta grumbullojnë dhe paketojnë ndihmën humanitare në Republikën e Maqedonisë. Në periudhën prej 18 deri më 31 maj të vitit 2014 në magazinat e Kryqit të kuq të RM-së në Shkup, u angazhuan gjithsej 690 vullnetarë të cilët dhanë kontribut me 7600 orë vullnetare për grumbullim, paketim, shkarkim, ngarkim të ndihmës humanitare dhe aktivitete tjera. Gjithashtu në periudhën e njëjtë angazhuan edhe rreth 500 vullnetarë në organizatat komunale të KKRМ-së me angazhim prej 5.500 orëve, apo gjithsej në aktivitete morën pjesë 1190 vullnetarë me 13100 orë vullnetare, të cilët dhanë kontribut për realizim të suksesshëm të aktiviteteve humanitare.

Për popullatën e pësuar nga përmbytjet në Serbi gjithsej janë dërguar 27 kamionë me 560.560 kg ndihmë humanitare me vlerë prej 9.969.363 denarë/162.198 euro. Për popullatën që pësoi nga përmbytjet në Bosnje dhe Hercegovinë janë dërguar 23 kamionë me 421.916 kg ndihmë humanitare me vlerë prej 12.442.194 denarë/202.382 euro. Në llogarinë e Kryqit të kuq të Bosnjes dhe Hercegovinës janë transferuar 157.650 euro. Në llogarinë e Kryqit të kuq të Serbisë për përkrahjen e popullatës së mjeruar nga përm-

bytjet janë transferuar 164.188 euro. Në këtë periudhë nga përmbytjet janë përfshirë pjesë në Republikën e Kroacisë, ndërsa në shpirtin e humanitetit dhe solidaritetit qytetarët e Republikës së Maqedonisë dhuruan mjete financiare. Në llogarinë e Kryqit të kuq të Kroacisë për përkrahjen e popullatës që pësoi në përmbytjet të muajit maj të vitit 2014, janë transferuar 3.593 euro.

Më 05 qershor të vitit 2014 Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë organizoi mbledhje me ambasadorët e Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Bosnjes dhe Hercegovinës, përfaqësuesit e kompanive, qytetarë dhe institucione të cilët kanë dhuruar dhe organizuar aktivitete për sigurimin e ndihmës humanitare dhe përkrahje për popullatën e mjeruar nga rajonet e përmbytura, me qëllim që të bëhet shqyrtim në dokumentacion dhe të prezantohen rezultatet e arritura. Pas mbledhjes u mbajt edhe konferencë për shtyp për lajmërimin e rezultateve të përgjithshme deri tek opinioni i gjerë në RM-së.





Sigurimi i mashit tradicional i alpinistëve. Më 11.07.2014 në kuadër të Transverzales ndërkombëtare tradicionale “Rrugëtim në malet e Osogovës”, nën organizim të “RUEN” mbi 200 alpinistë nga vendi dhe jashtë vendit, mes cilëve edhe Klubi i të rinjve të KK Kriva Pallankë me 30 vullnetarë u ngjiten në RUEN 2285m. Ekipi për përgjigje gjatë katastrofave i OKKK Kriva Pallankë, në këtë ngjarje mori pjesë si përkrahje logjistike dhe sigurim të pjesëmarrësve.

Siguri në ujë në periudhën verore. Me fillimin e sezonit veror Qendrat për siguri në ujë të KK të qytetit të Shkupit dhe OKKK Ohër, në sipërfaqet me

ujë në territorin e Shkupit dhe Ohrit, me qëllim që të kujdesen për sigurinë e qytetarëve, angazhuan shpëtimtarë në ujë dhe atë: Shkup – 40 shpëtimtarë dhe në Strugë 6 shpëtimtarë në ujë.

Trajnimi SEESIM. Në periudhën prej 23-26.09.2014 në Qendrën për menaxhim me kriza u mbajt aktivitet trajnues SEESIM – 2014, trajnim simulues për Evropën juglindore, ku bartës ishte Ministria e mbrojtjes së RM-së. Trajnimi SEESIM 2014 është pjesë e procesit për bashkëpunim mbrojtës në Evropën juglindore – SEDM. Në këtë trajnim morën pjesë subjektet të cilat janë pjesë e sistemit për menaxhim me kriza dhe mbrojtje dhe shpëtim. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, mori pjesë me dy përfaqësues. Qëllimi i trajnimit ishte të promovohen përgatitjet nacionale dhe regjionale, si dhe bashkëpunimi mes pushteteve civile dhe qeveritare gjatë planifikimit të përgjigjes institucionale në katastrofa dhe sulme të ndryshme.

Bashkëpunimi bilateral me Kryqin e kuq të Bullgarisë. Në periudhën prej 24-28.09.2014 Kryqi i kuq i Bullgarisë organizoi trajnim regjional koordinues Qustendill 2014 për përgjigje gjatë katastrofave (përmbytjet) ku mori pjesë ekip prej 4 anëtarëve të Kryqit të kuq të RM-së.

Si pjesë përfundimtare e projektit “Rritja e kapaciteteve të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në organizimin e punës në fushën e sigurisë në ujë, sigurim të sipërfaqeve me ujë dhe përmirësim të akteve normative në Republikën e Maqedonisë”, që në mënyrë financiare u përkrah nga Ministria e punëve të jashtme të Republikës së Bullgarisë, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë më 25.11.2014 në hapësirat e Panairit të Shkupit – halla diplomatike organizoi Panel – diskutim për sigurinë dhe shpëtimin në ujë

në Republikën e Maqedonisë.

Ulja e rreziqeve nga katastrofat. Në dhjetor në kuadër të projektit për Aktivitete për uljen e rreziqeve nga katastrofat që në mënyrë financiare u përkrah nga Gjysmëhëna e kuqe e Turqisë, OKKK Radovish dhe OKKK Gostivar filluan me implementimin e aktiviteteve për vlerësimin e rreziqeve dhe katastrofave në shkolla ku u realizua projekti (në 3 shkolla në Radovish 3 Mavrovë-Rostushë), si aktivitete me përfaqësuesit e njësive rajonale të QMK-DMSH-NjVL për grumbullimin e dokumentacionit ekzistues për vlerësimin e rreziqeve nga katastrofat dhe fatkeqësitë në rajonet e lartpërmendura.

Iniciativa për preventivë dhe përgatitje për katastrofa në Evropën juglindore. Në kuadër të programit trajnues të Iniciativës për preventivë dhe përgatitje për katastrofa të Evropës juglindore (DPPI SEE) për vitin 2014 në organizim të Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim, prej 8 deri 12 dhjetor u mbajt kurs ndërkombëtar me temë “Ujë, sanim dhe higjienë gjatë katastrofave në kontekst urban”. Në trajnim, përkrah Kryqit të kuq të Maqedonisë, morën pjesë edhe përfaqësues të Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim, Instituti për shëndet publik të RM-së, si dhe përfaqësues nga Shqipëria, Bullgaria, Serbia, Sllovenia, Kroacia, Mali i Zi dhe Turqia. Është interesante të përmendet se në delegacionet pothuajse nga secili shtet kishte përfaqësues nga shoqata e atjeshme nacionale, që është tregues plotësues i rolit të Kryqit të kuq në secilin shtet. Qëllimi i trajnimit ishte përforcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhim me ujë, sanim dhe higjienë në kushte të katastrofave në mjedise urbane.

SHËRBIMI PËR KËRKIM

Çdo ditë mijëra familje janë të ndara si rezultat i konflikteve të armatosura, katastrofave natyrore apo migrimeve. Vuajtjet njerëzore janë të mëdha kur të ndërpriten kontaktet me personat më të afërt dhe më të dashur dhe kur nuk ka asnjë lloj informacioni për fatin e tyre. Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të kuq dhe shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, punojnë së bashku gjithkund në botë t'i locojnë rastet e tilla dhe tu jepet ndihmë familjeve që për sëri të realizojnë kontakte.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë edhe këtë vit ishte ftuar dhe mori pjesë me përfaqësuesin e vet, në **mbledhjen vjetore për relaizimin e lidhjeve familjare** ku marin pjesë shoqatat nacionale shtetet e të cilave janë anëtare në BE, Kryqi i kuq Amerikan, Kryqi i kuq i Kanadasë, Kryqi i kuq i Australisë dhe Gjysmëhëna e Turqisë, ndërsa dy vite me rradhë edhe shoqatat nacionale të Gadishullit ballkanik. Mbledhja u mbajt prej 07 deri më 11.10.2014 në Sofje, Bullgari, ndërsa tema kryesore e mbledhjes ishte migrimi dhe sfidat me të cilat ballafaqohen Shërbimet për kërkim në shoqatat nacionale të KK dhe GJHK në këtë plan.

Në kontekst të Fenomenit evropian të migrimeve, i cili shumë e më shumë merr domethënie, e që e brengos edhe shtetin tonë, Kryqi i kuq i RM-së më 25.11.2014, organizoi **Tryezë të rumbullakët me temë: "Migrimet sfidë e re për Shërbimin për kërkimin e personave të zhdukur dhe realizim të lidhjeve familjare të Kryqit të kuq të Republikës së**



Maqedonisë", me qëllim që më mirë t'i paraqesë aktivitetet e Shërbimit për kërkim të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

Tryeza e rumbullakët u inicua për shkak të interesit të përbashkët për zgjidhje pozitive të problemit me migrimet në Republikën e Maqedonisë. Në këtë ngjarje u bisedua për fenomenin e migrimeve dhe mundësitë për veprim të përbashkët në këtë plan në Republikën e Maqedonisë. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Ministrisë për punë të brendshme, Qendrës për azilantë, Qendrës tranzite për migrantë, UNHCR dhe organizatave joqeveritare, me të cilët për momentin mundohemi që në mënyrë partnerore të përgjigjemi në sfidën me numrin e rritur të migrantëve në vendin tonë. Në këtë mbledhje morën pjesë edhe përfaqësues të Zyrës rajonale të Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq në Beograd,

Kryqit të kuq të Serbisë dhe Kryqit të kuq të Bullgarisë, me të cilët u këmbyen përvoja në këtë plan, duke pasur parasysh situatën e ngjashme me migrantët në shtetet e tyre.

Sipas të dhënave statistikore të Shërbimit për kërkim të Kryqit të kuq të RM-së, gjatë vitit të kaluar janë filluar 2 raste të personave të zhdukur, që kanë të bëjnë me persona të zhdukur si rezultat i migrimeve ekonomike të shtetasve të Maqedonisë jashtë shtetit tonë dhe 3 raste të migrimeve nga Siria dhe Avganistani në RM-së, me çka Shërbimi për kërkim të KKR-së në bashkëpunim me Zyrën regjionale të Komitetit ndërkombëtar të KK i realizuan të gjitha aktivitetet e nevojshme për realizimin e lidhjeve familjare të personave të cilët ishin të kyçur në procedurën e kërkimit.

VEPRIMTARI SHËNDETËSORE – PREVENIVE

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në pajtueshmëri me Planin strategjik për veprimtari shëndetësore preventive 2011 – 2015 në vitin që kaloi implementoi aktivitete në teren me qëllim që ta përmirësojë gjendjen shëndetësore të grupeve më të mjeruara gjegjësisht për preventivë nga HIV transmissioni mes grupeve më të rrezikuara të popullatës, përmirësim të kontrollit të tuberkulozit në nivel lokal, kujdesi shëndetësor i personave të moshuar, si dhe ulja e ndikimit dhe pasojave shëndetësore nga ndryshimet klimatike ndaj shëndetit të njeriut.

Ulja e dëmeve nga përdorimi i drogave është projekt dedikuar për personat – përdorues të drogave dhe zhvillohet në territorin e tre organizatave komunale të KK Kërçovë, Veles dhe Prilep. Qendrat e hapura në Organizatat komunale kanë për qëllim të ofrojnë shërbime mjekësore, sociale dhe juridike për përdoruesit si dhe t'i furnizojnë të njëjtit me prezervativë dhe pajisje sterile për injektim, material edukativ informativ.

Qëllimi i projektit është ulja e dëmeve nga përdorimi i drogave, në drejtim të përmirësimit të statusit shëndetësor, social dhe ekonomik të përdoruesve. Përdoruesit e drogave kanë mundësi të marrin pajisje sterile për injektim si dhe këshilla rreth dëmeve të mundshme të nxitura nga përdorimi i pajisjeve josterile siç është HIV/SIDA dhe hepatiti B dhe C.

Në bashkëpunim me Institutin për shëndet publik dhe OJQ HERA u zhvillua edhe këshilla të besueshme në teren dhe testim në Prilep dhe Veles. Njëpërmjet realizimit të punëtorive kreative të cilat kanë për qëllim risocializimin e klientëve të njëjtit patën mundësi ta shprehin talentin e tyre nëpërmjet vizatimit, përpunimit të zburimeve dhe gjëra të ndryshme nga glina, letra etj.

Me projektin gjatë vitit 2014 u përfshinë 541 persona nga popullata përdoruese. Për nevojat e përdoruesve janë ndarë 45 388 gjilpëra, 24 920 injeksione, 13519 prezervativë.

Përpunimi i planeve strategjike dhe operative të vetqeverisjes lokale. Gjatë vitit 2014 projekti u implementua në organizatën komunale të KK Vallandovë. Qëllimi i projektit ishte krijimi i planit lokal strategjik operativ për kontrollin e tuberkulozit në nivel lokal, me çka do të kontribuohet për përmirësimin e orvatjeve nacionale të kontrollit të tuberkulozit. Projekti u realizua me përdorimin e metodologjisë së Zhvillimit të përbashkët të bashkësive të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe qëllimi i së cilit është të vërtetohen problemet dhe prioritetet në bashkësitë në drejtim të tuberkulozit dhe aktiviteteve të nevojshme të cilat duhet të hynë në kuadër të planit operativ.

Zbatimi i edukimeve për tuberkulozin për grupe të ndryshme qëllimore. Me qëllim të ngritjes së



vetëdijes publike tek popullata për preventivë nga tuberkulozi si sëmundje ngjitëse, mënyrat e mundshme të bartjes dhe mbrojtjes, mundësitë për shërim etj. Kryqi i kuq i RM-së gjatë vitit 2014 realizoi edukime për grupe të ndryshme qëllimore para se gjithash për ato që janë të rrezikshme për hasje me këtë sëmundje.

Projekti u realizua në disa organizata komunale të KK dhe atë në Strugë, Kriva Pallankë, Kavadar etj. Njëpërmjet këtyre edukimeve për ngritjen e vetëdijes dhe preventivën e tuberkulozit u përfshinë gjithsej 5.026 përfaqësues të pakicave etnike dhe grupeve qëllimore dhe është realizuar trajnim për 10 edukatorë për tuberkulozë.

Pjesëmarrje në punën e Mekanizmës nacionale koordinative të RM-së për luftë kundër HIV/SIDA dhe tuberkulozë. Kryqi i kuq i RM-së si në periudhën e kaluar, ashtu edhe në të ardhmen do të japë kontributin e vet dhe do të angazhohet për funksionim më të mirë të këtij trupi dhe mbikqyrje në programet financiare nga ana e Fondit global për luftë kundër SIDA, tuberkulozit dhe malaries në RM-së.

Kryqi i kuq i RM-së në mënyrë aktive mer pjesë edhe në punën e **Komitetit nacional për ndryshime klimatike dhe Komisionit për ndryshime klimatike dhe shëndet pranë Ministrisë së shëndetësisë dhe në orvatjet e përbashkëta intersektore për mbrojtjen e popullatës në kushte të temperaturave ekstreme të jashtme, si dhe në aktivitetet me qëllim adaptimin në ndryshimet klimatike.**

Ndryshimet klimatike – mbrojtje e shëndetit nga ndryshimet klimatike (valë të nxehta, të ftohta). Aktivitetet në pajtueshmëri me planin aksional për kohë të nxehtë filloi me përgatitje dhe distribuim të materialit edukativ informativ për grupe të ndryshme

qëllimore për mbrojtje nga valët e nxehta / të ftohta njëpërmjet organizatave komunale të KK në territorin e tërë shtetit dhe qendrat për shëndet publik, si dhe Instituti për mjekësinë e punës. Në periudhën e muajve verore aktive ishte edhe linja SOS për valë të nxehta në kuadër të KK të qytetit të Shkupit, për dhënien e këshillave pa pagesë për mbrojtjen e shëndetit nga valët e nxehta. Në disa kthime gjatë muajve verore KKRMS-së njëpërmjet organizatave komunale ndërmori aktivitete për sigurimin e ujit në shishe që iu ofroheshte qytetarëve gjatë valëve të nxehta si dhe fletushka me këshilla për mbrojtjen e shëndetit personal, matjen e shtypjes së gjakut dhe sigurimi i ndihmës së parë gjatë nevojës eventuale për atë.

Trajnim simulues për testim të rregullores ndërkombëtare shëndetësore. Më 18 nëntor në aeroportin "Aleksandi i Madh" u mbajt trajnim simulues i rastit të dyshimtë me ebollë me pjesëmarrje të përfaqësuesve të Ministrisë së shëndetësisë dhe institucione tjera kompetente, si dhe Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë. Qëllimi i trajnimit ishte testimi i protokoleve standarde operative në drejtim të procedurës, komunikimit dhe koordinimit të sistemit shëndetësor në RM-së gjatë paraqitjes së mundshme të rrezikut publik shëndetësor me karakter ndërkombëtar (në këtë rast Ebola) në pikën hyrëse Aeroport. Trajnimi u realizua në kuadër të Konferencës ndërkombëtare të ministrave të shëndetësisë të vendeve të Evropës juglindore. Kryqi i kuq i RM-së si deri tani mori pjesë aktive dhe kontribut në përgatitjen, organizimin e trajnimit me përkrahje profesionale dhe logjistike, si dhe në vet realizimin e skenarit të paramenduar për trajnimin me vullnetarë të vet në rolin e udhëtarëve dhe rasteve të dyshimta të të sëmurëve nga ebola.

NDIHMË E PARË

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë njëpërmjet organizatave komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit gjatë vitit 2014 mbajtën gjithsej 1.104 kurse nga ndihma e parë për trajnim të kandidatëve për vozitës ku u trajnuan 13.995 persona, si dhe 187 kurse nga ndihma e parë për trajnimin e të punësuarve në organizata pune ku u trajnuan 1.196 persona.

Kurs për trajnimin e ligjëruesve dhe demonstratorëve nga ndihma e parë për kandidatë për vozitës. Në pajtueshmëri me Rregulloren për përmbajtjet e programit për aftësimin e ligjëruesve për prezantimin e programit mësimor për dhënien e ndihmës së parë për personat e lënduar në aksidente trafiku, për nevojat e OKKK më 25 dhe 26 janar të vitit 2014 Kryqi i kuq i RM-së mbajti kurs për trajnimin e ligjëruesve dhe demonstratorëve nga ndihma e parë për kandidatë për vozitës. Në kursin morën pjesë 17 kandidatë prej të cilëve 12 ishin ligjërues dhe 5 demonstratorë të OKKK.

Pjesëmarrje në trajnimin simulues nga ndihma e parë. Më 22 maj të vitit 2014 në Shkup u mbajt trajnim simulues "Aksident trafiku me numër më të madh të të lënduarve dhe me djegie" në organizim të Ministrisë së shëndetësisë të RM-së. Qëllimi i trajnimit ishte që të ngritet shkalla e përgatitjes gjatë situatave në krizë, në kuadër të prioritetit për Siguri shëndetësore, përgjigje dhe përgatitje gjatë situatave në krizë.

Kryqi i kuq i RM-së në këtë trajnim mori pjesë me 20 vullnetarë (manekene dhe grimues të cilët në mënyrë reale i paraqitën lëndimet.

Seminar për trajnim të grimerëve për paraqitje



reale të plagëve dhe lëndimeve. Seminari për grimerë u mbajt në periudhën prej 16 deri më 20 qershor të vitit 2014 në Strugë, ku morën pjesë 13 vullnetarë dhe 4 ligjërues / instruktorë. Në këtë seminar për edukimin e grimuesve u përpunuan tema nga ndihma e parë, njohja me materialin dhe përgatitja për përpunimin e grimeve dhe paraqitja e trajnimeve praktike. Nëpërmjet trajnimit dhe praktikave pjesëmarrësit punuan në skenarin për paraqitje reale të lëndimeve dhe plagëve. Gjatë testimit të diturive të tyre, pjesëmarrësit treguan njohuri solide dhe që të gjithë e dhanë testin me çka u hasën me emërimin grimerë për paraqitje reale të plagëve dhe lëndimeve.

Gara e XXIII-të shtetërore e ekipeve nga ndihma e parë. Në organizim të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë më 19/20 shtator të vitit 2014 në Kumanovë u mbajt Gara e XXIII-të shtetërore e ekipeve nga ndihma e parë, nën moton “Ndhimja e parë në fatkeqësitë dhe katastrofat e përditshme”. Në këtë garë morën pjesë 26 ekipe nga ndihma e parë, prej të cilëve 25 nga organizatat komunale të KK dhe 1 ekip revial i Organizatës qytetare të Kryqit të kuq Nish – Republika e Serbisë.

Vendin e parë në garë e mori ekipi nga ndihma e parë e OKKK Qendër, vendin e dytë e mori ekipi nga ndihma e parë e OKKK Kisella Vodë ndërsa vendi i tretë i takoi ekipit nga ndihma e parë e OKKK Veles. Në bazën për diseminim më të mirë ishin ekipet e OKKK Koçan, Probishtip dhe Kumanovë të cilët treguan njohje më të mirë për Lëvizjen, vizionin dhe misionin e Kryqit të kuq. Garën shtetërore nga ndihma e parë e vizitoi edhe kryetari i komunës së Kumanovës z. Zoran Damjanovski.

Mbledhje e anëtarëve të rrjetit për ndihmë të parë në Evropë. Në organizim të Kryqit të kuq të Francës në periudhën prej 09 – 11 tetor 2014 u mbajt mbledhje e anëtarëve të rrjetit për ndihmë të parë prej 38 shoqata nacionale të Kryqit të kuq dhe GJHK në Evropë, si dhe përfaqësues të Kryqit të kuq të Amerikës. Qëllimi kryesor i mbledhjes ishte përforcimi i programeve për ndihmë të parë nëpërmjet lidhjes rrjetore dhe bashkëpunimit të Shoqatave nacionale. Kryqi i kuq i RM-së si anëtar e këtij rrjeti në mënyrë aktive mori pjesë në mbledhjen dhe kishte mundësi t’i bartë përvojat e procesit për përforcimin me Qertifikatë evropiane për ndihmë të parë për kandidatë për pozitës edhe nëpërmjet shembullit të tij që t’iu ndihmon shoqatave tjera nacionale që të marrin certifikatin e tyre.

DHURIMI I GJAKUT

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë dhe Instituti për mjekësi transfuziologjike në vitin 2014 nga 55000 njësi gjaku të planifikuara realizuan 55513 njësi gjaku apo obligimet e planifikuara i plotësuan me 100.93%.

Në qytetin e Shkupit, organizatat komunale të KK Gazi Babë, Karposh, Kisella Vodë, Qendër dhe Çair në vitin 2014 realizuan 15037 njësi gjaku apo obligimet e planifikuara i plotësuan me 96.19%. në organizatat komunale të KK nga brendësia, në vitin 2014 u realizuan 38342 njësi gjaku. Në Spitalin e përgjithshëm të qytetit "8 Shtatori" në Shkup, në Shërbimin për mjekësi transfuziologjike u realizuan 2041 njësi. Në Qendrën ditore për dhurimin e gjakut në "Dare Xhambaz" në Shkup u realizuan gjithsej 2201 njësi gjaku prej të cilave 1665 me dhurim me vetiniciativë të gjakut nga qytetarët e Shkupit, ndërsa nëpërmjet aksioneve të organizuara për dhurimin e gjakut u grumbulluan 536 njësi gjaku prej të cilave 165 njësi gjaku nga dhuruesit e parë të gjakut.

Obligimet e planifikuara për dhurimin e gjakut në citin 2014 plotësuan 16 organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe atë: Manastir 112.23%, Vallandovë 109.65%, Veles 226.65%, Vinicë 315.03%, Dellçevë 125.89%, Kavadar 166.27%, Kratovë 130.52%, Kriva Pallankë 145.85%, Krushevë 112.14%, Prilep 100.40%, Probishtip 136.93%, Sh. Nikollë 180.86%, Strugë 101.92%, Shtip 191.21%, Gazi Babë 125.04% dhe Qendër 181.64%.

Ekipi për koordinim, gjatë vitit 2014 mbajtën 94 mbledhje koordinuese ku u morën vesh dhe u realizuan 875 aksione për dhurimin e gjakut në teren.

Memorandume të nënshkuara për bashkëpunim me institucione shtetërore. Në muajin mars të vitit 2014 u nënshkrua Memorandum për bashkëpunim në veprimtarinë e dhurimit të gjakut mes Ministrisë së mbrojtjes, Kryqit të kuq të RM-së dhe Institutit për mjekësi transfuziologjike, si dhe Memorandum për bashkëpunim me Institutin për mjekësi transfuziologjike dhe Kodeks të sjelljes së personave të punësuar profesional në KKRM-së dhe Institutin për mjekësi transfuziologjike të kyçur në procesin e realizimit të aksioneve për dhurimin e gjakut.

U shënuan 17 marsi Dita e dhurimit të gjakut në RM-së dhe 14 qershori Dita botërore e dhurimit të gjakut. Më 17 mars të vitit 2014 u mbajt mbledhja e 5-të e Kuvendit të Kryqit të kuq të RM-së. Para delegatëve dhe mysafirëve të pranishëm me fjalime të shkurta u drejtuan kryetari i KKRM-së d-r Millço Trajkov, drejtori gjeneral dhe kryetari i SHA Alkaloid z. Zhivko Mukaetov përfaqësuesi i EVN Maqedoni z. Igor Gievski. Shpërblimet për tre OKKK më të suksesshme Vinicë, Shtip dhe Qendër i ndau z. Zhivko Mukaetov, ndërsa pakot për planin e plotësuar në vitin 2013 për 18 OKKK i ndau z. Igor Gievski.

14 qershori – Dita botërore e dhurimit të gjakut u shënuar nën moton "Dhuroni gjak për ata të cilët japin jetë", nën mbështetje të kryetarit të RM-së d-r Gjorge Ivanov. Ai e vizitoi Qendrën ditore për dhurimin e gjakut dhe dhuroi gjak. Në këtë ngjarje morën pjesë përfaqësuesit e KKRM-së, Institutit për mjekësi transfuziologjike, nga zyra, Agjencioni për

rini dhe sport, anëtarët e Klubit 25, dhuruesit e gjakut, sportistë të dalluar, emra të njohur nga estrada e Maqedonisë, gazetarë etj.

Seminare edukative të mbajtura për dhurimin vullnetar të gjakut. Në periudhën prej 09-11 maj 2014 në organizim të KKRM-së dhe Institutit për mjekësi transfuziologjike në Strugë u mbajt punëtori për edukimin e motivuesve të rinj në dhurimin e gjakut. Në këtë punëtori u edukuan 18 motivues të rinj për dhurim vullnetar të gjakut. Në periudhën prej 29-31 gusht në Strugë u mbajt seminar për edukimin e motivuesve të rinj në dhurimin e gjakut. Në këtë seminar morën pjesë 30 pjesëmarrës – motivues të rinj nga KK Shkup (anëtarë të Klubit 25), OKKK Ohër, Strugë, Gostivar, Kumanovë, Veles, Strumicë dhe Manastir, përfaqësues të KK Nish dhe KK Novi Sad dhe përfaqësuesi i KK të Sllovenisë.

Pjesëmarrje në seminare ndërkombëtare për dhurimin vullnetar të gjakut. Prej 26 – 29 shtator u mbajt Seminar rajonal për dhurimin e gjakut në Shkodër Republika e Shqipërisë nën moton "Së bashku për dhurim vullnetar të gjakut". Pjesëmarrës në këtë seminar ndërkombëtar ishin përfaqësuesit e KK të Shqipërisë, Italisë, Maqedonisë dhe Kosovës. Nëpërmjet prezantimeve u prezantuan aktivitetet në veprimtarinë e dhurimit të gjakut dhe të Klubeve 25. U mbajtën dy punëtori për të rinjtë me temë "Partneriteti mes të rinjve për promovim të suksesshëm të dhurimit vullnetar të gjakut" dhe "Numri i rritur i dhuruesve të rinj të gjakut".

Këshillë ndërkombëtare për dhurim vullnetar të gjakut. Në organizim të Organizatës qytetare të KK Novi Sad dhe Entit për transfuzion të gjakut në Vojvodinë në periudhën prej 10-12 tetor të vitit 2014 u

mbajt Këshillë ndërkombëtare për dhurim vullnetar të gjakut ku mori pjesë përfaqësues i KKRM-së i cili e prezantoi modelin e planifikimit të përbashkët dhe organizimit të dhurimit të gjakut në RM-së mes Kryqit të kuq dhe Shërbimit për mjekësi transfuziologjike si dhe përvojat nga puna e Qendrës ditore për dhurimin e gjakut.



VEPRIMTARI SOCIALE – HUMANITARE

Aktivite për përkrahjen dhe kujdesin për personat e moshuar

Kryqi i kuq i RM-së si anëtar i Trupit nacional koordinues për përcjelljen dhe evaluimin e implementimit të Strategjisë nacionale për personat e moshuar, në mënyrë aktive kyçet dhe jep kontribut në orvatjet e përgjithshme të cilat i ndërmarin institucionet kompetente në realizimin e të drejtave, kujdesi dhe mbrojtja e patjetërsueshme e personave të moshuar në Maqedoni. KCRM-së edhe gjatë vitit 2014 vazhdoi me implementimin e projektit “Kujdesi për personat e moshuar në kushte shtëpiake”. Projekti u implementua në shtatë komuna dhe atë në Shkup, Kriva Pallankë, Veles, Dibër, Kërçovë, Prilep dhe Gostivar, me aktivitetet projektuese nëpërmjet të cilëve sigurohen shërbime sociale dhe mjekësore, janë përfshirë gjithsej 480 persona të moshuar më të vjetër se 65 vjet, të cilët jetojnë vet. Ata çdo javë vizitohen nga ana e motrës medicinale dhe nga vullnetarë të cilët janë të trajnuar për punë me persona të moshuar.

Në aktivitetet projektuese janë angazhuar gjithsej 140 vullnetarë dhe 16 motra medicinale. Në ekipet e vullnetarëve të KK, përkrahës të rinj, janë kyçur edhe pensionistët të cilët janë vital dhe kanë dëshirë ta kalojnë kohën e tyre në aktivitete vullnetare humanitare. Aktivitetet projektuese janë përkrahur nga ana e EVN Maqedoni, Kryqi i kuq i Austrisë dhe kompania UNIQA nga

Austria. Aktivitetet në kuadër të Projektit “Kujdes për personat e moshuar në bashkësi” që implementohen nëpërmjet organizatave komunale të KK Prilep, Gostivar dhe Kërçovë në bashkëpunim me 11 shoqata qytetare, janë financuar nga Bashkimi evropian.

Partner i këtij projekti është Kryqi i kuq i Austrisë. Në kuadër të projektit u organizuan trajnime për 60 vullnetarë dhe 6 motra medicinale të cilët ofrojnë shërbime sociale dhe mjekësore për gjithsej 180 persona të moshuar. Në muajin shtator të vitit 2014 u mbajtën dy punëtori për menaxhim kualitativ të programeve për kujdesjen e personave të moshuar, që u përkrah nga ana e përfaqësuesit edukator të KK të Austrisë, si punëtori informative me qëllim që të përmirësohet informimi i ekipeve lokale të angazhuar në projektin për plakje aktive dhe kyçje sociale, të cilët do të kenë mundësi të zhvillojnë koncept për krijim të mëtutjeshëm të iniciativave për kyçje aktive të personave të moshuar në programe. Aktivitetet projektuese janë paraparë të implementohen deri në qershor të vitit 2015.

Qendra ditore për persona të moshuar dhe qendra për dhënien e ndihmës për personat e moshuar në kushte shtëpiake

Qendra ditore për persona të moshuar dhe qendra për dhënien e ndihmës së parë për persona të moshuar në kushte shtëpiake që funksionon nëpërmjet KK të qytetit të Shkupit dhe gjatë vitit



2014 vazhdimisht siguroi përkrahje dhe kujdes për personat e moshuar. Aktivitetet projektuese janë përkrahur nga Qyteti i Shkupit. Me këtë projekt janë përfshirë 120 persona të moshuar të cilët rregullisht vizitohen nga ana e vullnetarëve dhe motrave medicinale.

Në muajin shkurt me përkrahjen e Komunës Gazi Babë është hapur edhe një qendër për persona të moshuar dhe qendra për dhënien e ndihmës në kushte shtëpiake.

Aktivitetet implementohen nëpërmjet Organizatës komunale të KK Gazi Babë me të cilin janë përfshirë 90 persona të moshuar. Nëpërmjet qendrës organizohen aktivitete dedikuar për përkrahjen dhe kujdesin e personave të moshuar të komunës, vizitë e personave të moshuar në kushte shtëpiake, si dhe aktivitete edukative, kreative dhe rekreative.

Klubi i pensionistëve

Klubi "Jetë dinjitoze" pranë Organizatës komunale të KK Kriva Pallankë, ku në mënyrë aktive marin pjesë 40 persona edhe gjatë vitit 2014 realizoi aktivitete drejtuar kah kyçja e personave të moshuar në aktivitetet shoqërore të bashkësisë dhe përditshmëri të plotësuar. Qëllimi kryesor është përmirësimi i kualitetit të jetës së pleqve, nëpërmjet përmirësimit të gjendjes së tyre psiko – sociale, edukative dhe kreative, punëtori, hasje me aftësi dhe komunikime të reja, kujdes për shëndetin e tyre, si dhe ndihmë humanitare.

Klubi i pensionistëve "Anri Dinan" nëpërmjet organizatës komunale të Kryqit të kuq Negotinë me

të cilën janë përfshirë gjithsej 30 persona vazhdoi në mënyrë aktive të funksionojë edhe gjatë vitit 2014. Gjithashtu edhe nëpërmjet këtij klubi u organizuan punëtori edukative dhe kreative, aktivitete rekreative etj.

Dita ndërkombëtare e personave të moshuar

Kryqi i kuq i RM-së me aktivitete e shënoi 1 tetorin Dita ndërkombëtare e personave të moshuar. Nëpërmjet Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatave komunale të Kryqit të kuq u organizuan punëtori edukative, garë nga ndihma e parë, punëtori kreative me personat e moshuar, të vetmuar në shtëpitë e tyre me kyçjen e vullnetarëve të rinj të KK dhe angazhim të punëtorëve shëndetësor, kontrollime pa pagesë për matjen e sheqerit në gjak dhe shtypjen e gjakut etj.

Java e kujdesit për personat e moshuar

Prej 17 deri më 23 nëntor të vitit 2014 nën moton: "Informohuni për të drejtat Tuaja nga mbrojtja sociale dhe shëndetësore", Kryqi i kuq i RM-së në mënyrë tradicionale e shënoi "Java e kujdesit për personat e moshuar" me qëllim që të ngritet vetëdija publike për të drejtat e personave të moshuar, si dhe të sigurohet përkrahja dhe kujdesi i personave të moshuar. Në kuadër të Projektit "Kujdesi i personave të moshuar në bashkësi", financuar nga Bashkimi evropian, u siguroa edhe përkrahja për

shënimin e Javës për çka u përgatitën materiale promovuese fletushka dhe postere me përmbajtje për informimin e personave të moshuar për të drejtat e tyre nga mbrojtja sociale dhe shëndetësore. Me këto aktivitete u përfshinë mbi 6000 persona të moshuar. Aktivitetet në nivel lokal u implementuan në bashkëpunim me shoqatat komunale të pensionistëve me të cilët Kryqi i kuq i RM-së vazhdimisht realizon bashkëpunim të mirë, si dhe me qendrat për punë sociale dhe shoqatat qytetare me të cilat organizatat komunale të KK realizojnë bashkëpunim partneror.

Përmirësimi i socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të posaçme

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Entin për punë sociale viti i gjashtë në vazhdimësi implementon iniciativa të përbashkëta për përmirësimin e socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të posaçme.

Me aktivitetet projektuese janë përfshirë mbi 320 fëmijë me nevoja të posaçme. Gjatë vitit përkaj aktiviteteve me fëmijët në qendrat ditore, u implementuan edhe aktivitete për përkrahjen e fëmijëve në familjet strehuese në Shkup, Veles dhe Prilep me të cilën u përfshinë 40 fëmijë. Në këto aktivitete u kyçën 19 vullnetarë të cilët fituan njohuri dhe aftësi elementare për përkrahjen e fëmijëve të familjeve strehuese në tre komunat. Me përkrahjen e Entit për punë sociale u përgatit material për punë me fëmijët "Përralla ime".

Aktivitetet vijuese si dhe shumë të tjera ishin pjesë e iniciativave të zbatuara bashkarisht në komunat: vizita e shtëpive të familjeve strehuese nga ana e ekipeve mobile të përbëra prej vullnetarëve të KK, punëtori kreative, organizim të aktiviteteve rekreative, edukime për fëmijë, prindërit dhe strehuesit e fëmijëve, përkrahje psikologjike për fëmijët dhe prindërit dhe shumë aktivitete tjera. Më 16.12.2014 u mbajt punëtori për evaluimin e aktiviteteve projektuese në prani të përfaqësuesve të organizatave komunale të KK dhe qendrat ditore ku përfaqësuesi i Bankës komerciale shprehi kënaqësinë nga aktivitetet e implementuara deri tani dhe efektet e arritura.

Lufta kundër tregtisë me njerëz

Aktivitetet e Kryqi të kuq të RM-së për preventivë nga tregtia me njerëz në vitin 2014 u implementuan mbi 16 organizata komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit. Kryqi i kuq i RM-së me përkrahjen e Shoqatës gjermane për përkrahje ndërkombëtare të programeve sociale (GIZ) dhe Ministrisë për punë dhe politikë sociale më 9 prill 2014 mbajti punëtori edukative për trajnimin e 19 vullnetarëve të 6 organizatave komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit për zbatimin e metodës së re për organizimin e punëtorive preventive. Vullnetarët e KK gjatë punëtorive preventive me rininë e shkollave fillore dhe të mesme, përkaj teknikave të drejtanishme e praktikon edhe mjetin – video projekte (pantomima).

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta edukative të KK drejtuar për preventivë nga tregtia me njerëz,



ekip i përbërë prej 5 vullnetarëve nga Klubi i të rinjve të OKKK Karposh së bashku me aktorë profesional e luajtën shfaqen me titull “Shenja” me temë dhe përmbajtje lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me rreziqet nga tregtia me njerëz. Për përcjelljen e shfaqes patën mundësi ta përcjellin 600 vizitorë – bashkëpunëtorë, përkrahës të KK, ndërsa numri më i madh prej tyre nxënës nga shkollat fillore dhe të mesme.

Dita evropiane për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe Java e luftës kundër tregtisë me njerëz

Kryqi i kuq i RM-së si anëtar i Sekretariatit të Komisionit nacional për luftë kundër tregtisë me

njerëz dhe migrimit ilegal me organizim të aktiviteteve preventive u kyç në shënimin e 18 tetorit – Dita evropiane e luftës kundër tregtisë me njerëz dhe prej 2-9 dhjetor Java e luftës kundër tregtisë me njerëz. Me rastin e aktiviteteve tradicionale u organizuan punëtori për edukim moshatar të të rinjve në shkollat fillore dhe të mesme që u zbatuan nëpërmjet organizatave komunale të Kryqit të kuq. Mësimet preventive kishin për qëllim ngritje e vetëdijes së të rinjve, njohjen e mënyrave nëpërmjet të cilave rinia mund të jenë të futur në tregtinë me njerëz dhe vetmbrojtja e tyre. Nëpërmjet 69 punëtorive edukative u përfshinë mbi 2415 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme.

Pushim dhe rekreacion për fëmijët e familjeve me rrezik social dhe fëmijë përdorues të shtesave të posaçme

Ministria e punës dhe politikës sociale gjatë dimrit organizoi pushim pa pagesë dhe rekreacion për fëmijët e familjeve me rrezik social, fëmijë përdorues të shtesave të posaçme dhe të drejta tjera në pushimorën “Pelister” në Manastir. Kryqi i kuq i RM-së u kyç në këtë aktivitet projektues me angazhimin e vullnetarëve të KK në rolin e edukatorëve me qëllim që të animohen fëmijët gjatë qëndrimit të tyre. Ministria e punës dhe politikës sociale këtë projekt e implementoi edhe gjatë periudhës së verës, ku përkrahje gjeti KKRMs. Vullnetarët e angazhuar të KK edhe gjatë muajve korrik gusht 2014 i shoqëruan dhe realizuan aktivitete adekuate programore me fëmijët në pushimorën për fëmijë “Lulja e Majit” – Strugë.

“Kontributi juaj – ndihmë e rëndësishme”

Kryqi i kuq i RM-së nën moton “Kontributi juaj – ndihmë e rëndësishme” prej 22 deri më 28 prill 2014 me aktivitete e shënoi “Javën e solidaritetit”. Në kuadër të javës Kryqi i kuq organizoi Aksion grumbullues me qëllim që të zgjohet ndjenja e humanitetit dhe solidaritetit tek qytetarët, posaçrisht tek gjenerata e re për ndihmë dhe përkrahje mes veti, si dhe të sigurohet ndihmë adekuate për kategoritë më të mjeruara të popullatës. Në këtë aksion u sigurua donacion prej 1.900 kg ushqim, 10.300

kg rroba, 720 parë mbathje dhe mjete financiare.

Gjatë kësaj jave u organizua edhe aksioni “Prej shtëpie në shtëpi” ku vullnetarët e organizatave komunale të KK vizituan qytetarët në shtëpitë e tyre për sigurimin e donacionit të mjeteve financiare. Qytetarët në këtë aksion dhuruan gjithsej 210.000 denarë. Mjetet e grumbulluara nga aksioni u dedikuan për sigurimin e ndihmës në ushqim të cilët i ndanë familjeve me rrezik të posaçëm.

“Mendoni për ne”

Kryqi i kuq i RM-së me rastin e 16 Tetorit nën moton “Mendoni për ne” e realizoi fushatën për sigurimin e ndihmës për popullatën e mjeruar në vend. Në kuadër të fushatës organizatat komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit organizuan aktivitete humanitare në bashkëpunim me institucionet arsimore – edukative, në bashkëpunim dhe përkrahje të kompanive dhe qytetarëve, si dhe në bashkëpunim me sektorin qytetar. Në fushatë u siguruan gjithsej 580.000 denarë, të cilat ishin dedikuar për furnizimin e ushqimit. Në këtë aksion janë siguruar 19.700 kg ushqim dhe 2.700 kg rroba dhe të njëjtat janë ndarë në grupet e mjeruara qëllimore të popullatës.

Aksioni humanitar “Të ndajmë lumturi”

Kryqi i kuq i RM-së për herën e katërt në bashkëpunim dhe përkrahje të EVN Maqedoni me rastin e festave të vitit të ri organizuan aksion të përbashkët humanitar “Të ndajmë lumturi”. Qëllimi i

këtij aksioni ishte që tu dhurohet buzëqeshje dhe lumturi fëmijëve të familjeve të rrezikuara sociale dhe fëmijëve me nevoja të posaçme dhe të ndahen momentet e lumtura për festat e vitit të ri. Për këtë aksion u siguruan gjithsej 680 dhurata për vitin e ri, të cilat iu dhuruan fëmijëve në ngjarje të organizuara nga ana e Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatave komunale të KK: Koçan, Kërçovë, Strugë, Shtip, Gjevgjeli dhe Strumicë, në bashkëpunim me të punësuarit e EVN në komunitat. Më 12 dhjetor 2014 u organizua manifestim për vitin e ri në Teatrin për fëmijë dhe të rinj, ku në mënyrë zyrtare iu ndanë dhuratat fëmijëve nga ana e përfaqësuesit të EVN Maqedoni dhe sekretarit të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit.



Punkt për rroba

Kryqi i kuq i RM-së në kuadër të bashkëpunimit të frytshëm që e realizon me Alfa Banka SHA Shkup siguroi përkrahje për aktivitetet projektuese për menaxhimin e rrobave të përdorura. Në kuadër të projektit më 18 maj 2014 Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit hapi Punkt për rroba funksionimi i së cilës ishte përkrahur nga ana e Bankës. Dita e hapjes, njëherit ishte edhe Dita e vullnetarizimit të Alfa Banka dhe e njëjta u shënuar me organizimin e aksionit humanitar me të punësuarit e bankës për dhurimin e veshmbathjeve, selektimin dhe paketimin e rrobave dedikuar për pikën.

Në vitin e kaluar si fazë e parë e këtij projekti të përbashkët, ishin vendosur 7 kontenjerë për dhurimin e rrobave. Kjo kontribuoi për rritjen e donacioneve në rroba. Me qëllim që të mundësohet në mënyrë të sistematizuar distribuimi i rrobave u hap kjo pikë që më tej është planifikuar të rritet në shitore për rroba ku qytetarët do të mund të blejnë rroba të përdorura me çmime të lira dhe të kapshme. Mjetet të cilat do të grumbullohen nga shitja do të dedikohen për vet funksionimin e shitores.

Barazi dhe jodiskriminim

Ministria e punës dhe politikës sociale në bashkëpunim me Këshillin e Britanisë dhe Ambasadës së Britanisë në Republikën e Maqedonisë, në kuadër të projektit për përfundimin e kapaciteteve të personave profesional për zbatim efikas të Strategjisë nacionale për barazi dhe jodiskriminim, më 27 dhe 28 shkurt në Veles, organizoi seminar për barazi dhe

jodiskriminim për nevojat e KKRМ-së. Në të njëjtën morën pjesë 20 vullnetarë dhe të punësuar të KKRМ-së, KK i qytetit të Shkupit dhe Organizata komunale e KK Veles.

Aksioni i përbashkët me Vinçini

Kryqi i kuq i RM-së në bashkëpunim me Vinçini, në periudhën prej 17 nëntor 2014 deri më 17 shkurt 2015 zbaton fushatë për sigurimin e mjeteve për përkrahjen e aktiviteteve projektuese për përmirësimin e socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të posaçme në qendrat ditore në Vinicë, Strumicë, Kumanovë dhe Shtip. Për këtë qëllim kompania Makprogres gjatë fushatës caktoi një prodhim nga Vinçini, ku me blerjen e prodhimit dhurohen 5 denarë për përkrahjen e fëmijëve me nevoja të posaçme në qendrat ditore. Pas mbarimit të aksionit mjetet e siguruar do të dhurohen në Kryqin e kuq të RM-së për implementimin e aktiviteteve projektuese.

Përkrahja e personave me invaliditet trupor

Kryqi i kuq i RM-së në bashkëpunim dhe përkrahje të kompanisë Alijans Uan Maqedoni siguroi përkrahje për implementimin e Projektit Përparimi i pozitës së personave me invaliditet trupor, që realizohet në periudhën nëntor 2014 – mars 2015. I njëjti implementohet nëpërmjet Organizatës komunale të KK Vinicë për të cilin është formuar ekip për aksionin për përcjelljen dhe realizimin e aktiviteteve, ku është kyçur edhe përfaqësues i kompanisë. Me aktivitetet

projektuese do të hapet Klubi nëpërmjet të cilit do të implementohen aktivitetet për përkrahjen e personave me invaliditet trupor në Komunën Vinicë.

Aksion humanitar me Stopanska Banka

Në pritje të festave të vitit të ri, Stopanska Banka SHA Shkup në bashkëpunim me KKRМ-së, në ditën e formimit të bankës, 29 dhjetori, dhuroi 506 pako me ushqim dhe mjete për higjienë për 253 familje sociale të rrezikuara në Shkup, Manastir, Strumicë, Vallandovë, Koçan, Gjevgjeli dhe Strugë. Dorëzimi zyrtar i donacionit u organizua në Shkup ku morën pjesë drejtori gjeneral për menaxhim me rreziqe të Stopanska Banka dhe sekretari gjeneral i KKRМ-së.

Me këtë donacion, banka në vitin kur shënoi 70 vjet nga ekzistimi i vet, edhe një herë e vërtetoi rolin e vet shoqëror përgjegjës. Donacioni përbëhet me prodhime më të nevojshme për ekzistencën e një familje, që u shpërndanë nëpërmjet KK të qytetit të Shkupit dhe organizatave komunale të Kryqit të kuq në bashkëpunim me të punësuarit e filialave në bankë.

Donacion të jorganëve për fëmijë

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me kompaninë Komfi Angel nga Prilepi organizoi aktivitetet të përbashkëta me rastin e shënimit të 1 gushtit – ekzistim dhjetëvjeçar i kompanisë. Me këtë rast kompania dhuroi 10.000 jorganë për fëmijë të cilat u shpërndanë për nevo-

jat e çerdheve për fëmijë dhe spitalet ku ka reparte për fëmijë në të gjithë territorin. Dorëzimi zyrtar i donacionit u bë më 19.08.2014 nga ana e drejtorit të kompanisë dhe Sekretarit gjeneral të KKRМ-së.

Donacion i ndihmës humanitare të Kryqit të kuq të Gjermanisë Baden Vürtemberg

Si rezultat i bashkëpunimit të frytshëm shumëvjeçar me KK të Gjermanisë në Baden Vürtemberg në muajin shtator të vitit 2014, KKRМ-së pranoi donacion ndihmë humanitare në elemente për kuzhinë, rroba dhe shatorë. Ndihma ishte dedikuar për realizimin e qëllimeve humanitare të Kryqit të kuq.



DISEMINIM

Edukim për veprimtari humanitare

Programi për diseminim të Kryqit të kuq të RM-së paraqet sistem të përhapjesë së unifikuar të diturive të lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, parimet themelore, ëmblema, e drejta ndërkombëtare humanitare si dhe rekrutimi i vullnetarëve të rinj nëpërmjet KKA – PVH. Promocioni i parimeve themelore si toleranca, jodhuna dhe paqja, zbatimi praktik i vlerave universale, kultura e dialogut, vlerat humane, raporti aktiv ndaj jetës, raporti human pa diskriminim, praktikimi i arsimimit humanitar si dhe përparimi i kyçjes sociale janë prioritete të posaçme në punën e shoqatës nacionale.

Gjatë vitit 2014 programi për diseminim lëvizte kah promovimi i arsimimit humanitar si qasje e Lëvizjes që paraqet platformë arsimore për edukim humanitar që zbatohet me qëllim zhvillimin e të gjitha programeve të cilat mundësojnë kyçjen e grupeve të ndryshme qëllimore, kyçjen e të rinjve të cilëve u mundësohet t'i analizojnë ngjarjet dhe dukuritë në aspekt humanitar, mobilizim të aksionit humanitar në shpirtin e Lëvizjes së KK dhe GJHK, parimet themelore dhe vlerat humane.

Nëpërmjet arsimimit formal, përforcimi i rezistencës së bashkësive, kultura e dialogut dhe qasja inkluzive kontribuoi ndaj shprehive, qasja në ak-

sionin humanitar dhe stimulimi i zbatimit praktik të parimeve themelore të Lëvizjes në bashkësi.



KOMITETI NACIONAL PËR DNH

Përcjellja e zhvillimit të të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe diseminimi i tij në segmente të ndryshme të jetës shoqërore

Me formimin e Komitetit nacional, Qeveria e Republikës së Maqedonisë shprehi përcaktimin e saj se statusi formal juridik nuk është i mjaftueshëm për implementim efektiv të DNH përderisa nuk përcillet me aktivitete adekuate të shoqatës nacionale, në drejtim të harmonizimit nëpërmjet ndërtimit të obligimeve në legjislativën nacionale apo implementimin e drejtpërdrejtë të obligimeve të cilat dalin nga marrëveshjet ndërkom-

bëtare, marja dhe vëzhgimi i masave.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë e miratoi "Informacionin për punën e Komitetit nacional për DNH për periudhën 2012 – 2014" me të cilin kryesonte Ministria e drejtësisë.

Në periudhën informative Komiteti nacional i DNH si primare i realizon aktivitetet që vijojnë: përparimi dhe nxitja e procesit të ratifikimit të konventave tjera për DNH, është formuar grup punues për mbrojtje të trashëgimisë kulturore gjatë konflikteve, nga përfaqësues të Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, e shqyrtoi Doracakun e Komitetit ndërkombëtar të KK për implementimin e DNH dhe vlerësoi se i njëjti është i mjet dobishëm në aktivitetet e institucioneve në nivel nacional për implementimin e DNH. Në vitin 2014 u shënuar 3 vjetori: 150 vjet të Konventës së Gjenevës (1864) për Përmirësimin e gjendjes së të plagosurve në fushën e betejës, 60 vjetori i Konventës së Hagës nga viti 1954 për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në rast të konfliktit të armatosur dhe Protokoli i parë dhe 15 vjetori nga Protokoli i dytë.

Në kuadër të shoqatës nacionale në vitin raportues, Komiteti nacional për DNH mbajti dy mbledhje. Në dy vitet vijuese me Komitetin nacional do të kryesojë Ministria e arsimit dhe shkencës.

PROGRAMI I KRYQIT TË KUQ NË AKSIONIN – PROMOVIMI I VLERAVE HUMANE (KKA – PVH)

Programi Kryqi i kuq në aksion – Promovimi i vlerave humane (KKA – PVH) gjatë ciklit të kaluar shënon rezultate më të mira deri më tani gjatë gjithë periudhës nga implementimi. Edukimin e tërësishëm e kaluan gjithsej 1.247 të rinj prej të cilëve 1.123 persona përpunuan projekte të vogla për mirëqenien e bashkësive. Janë përpunuar 210 projekte të vogla në periudhën prej tre muajve nëpërmjet të cilëve iu është ndihmuar 4.055 personave. Një pjesë e projekteve ishin të drejtuara kah lehtësimi i problemeve, por një pjesë e tyre edhe për zgjedhje të përhershme të të njëjtave. Të rinjtë gjithsej realizuan 30.828 orë vullnetare në periudhën prej tre muajve. Në muajin Maj u mbajtën edhe dy punëtori finale ku morën pjesë 140 të rinjë.

Programi në vitin 2014 u përkrah nga ana e Ambasadës Amerikane në Shkup. Medalja për më të mirët në vitin 2014 në kuadër të PVH u ndanë në Shkup dhe në Negotinë dhe Ohër, ku u realizuan më shumë projekte me titull diell, për ndryshime pozitive të arritura në bashkësi.

Tanimë viti i tretë me radhë mbahet edhe KKA – PVH javë e cila shënohet nga 21 – 27 shtator. Këtë vit u shënuar me vallëzim të përbashkët, emërtuar Flashmob, me këngën "I lumur" ku morën pjesë 1.400 të rinjë. Ngjarja ndodhi më 27 shtator, në çdo shesh në çdo qytet në Maqedoni me fillim prej orës 12:00. Rinia ndanin porosi të cilat u shkruan në të gjitha gjuhët Së bashku vallëzojmë – së bashku jetojmë.



AKTIVITETET E TË RINJVE

Gjatë muajit maj të vitit 2014 me sukses u zbatuan zgjedhjet e rregullta tek rinia në të gjitha nivelet e organizatës. Karakteristikë e posaçme për procesin zgjedhor ishte futur reforma në organizimin e të rinjve në futjen e trupave koordinues në nivel lokal dhe nacional.

Në periudhën prej 14 – 20 korrik 2014 në Qendrën për edukim dhe rekreacion të kuadrove “Solferino” u organizua trajnim për udhëheqje efikase të klubeve të të rinjve ku morën pjesë 60 vullnetarë – liderë të klubeve të të rinjve. Qëllimi i kampit ishte përforsimi i diturive dhe aftësive të vullnetarëve të rinj për kontribut aktiv në proceset e sjelljes së vendimeve dhe nënshkrim të partneriteteve me organizata tjera qeveritare dhe jo-qeveritare të cilat punojnë edhe me të rinj.

Në periudhën prej 21 – 27 korrik u mbajt edhe një kamp me temë: Trajnim të trajnuesve për edukatorë moshatar për programet e Kryqit të kuq. Në këtë kamp u trajnuan persona të klubeve të të rinjve të cilët në të ardhmen do të mund të trajnojnë edukatorë moshatar me theks në ndërtimin e aftësive për edukim dhe punë me të rinj, organizim të punëtorive, qasje dhe aftësi për komunikim, teknika të prezantimit etj.

Deri më 21.12.2014 në 31 klube të të rinjve të OKKK dhe KKQSH aktiv janë 1664 vullnetarë të rinj që paraqet rritje prej 342 vullnetarë në krahasim me vitin e kaluar.

Në mënyrë plotësuese me aktivitetet e veta në kuadër të klubeve të të rinjve janë organizuar edhe punëtoritë edukative që vijojnë në vitin 2014:

Punëtori edukative për preventivë dhe ngritjen e vetëdijes

TEMA	NUMRI I PUNËTORIVE	NUMRI I GRUPIT TË PËRF-SHIRË QËLLIMOR
PREVENTIVË NGA HIV./SIDA DHE INFEKSIONET SEKSUALE BARTËSE	168	4384
PREVENTIVË NGA TREGTIA ME NJERËZ	75	2251
PREVENTIVË NGA SËMUNDJE TË VARURA (ALKOOLI, DROGAT, THITHJA E DUHANIT)	93	2777
PREVENTIVË NGA SËMUNDJA E SHEQERIT	3	73
TRAJNIM PËR NDIHMË TË PARË	51	968
PROMOVIMI I DHURIMIT VULLNETAR TË GJAKUT	22	420
DISEMINIMI PËR KRYQIN E KUQ	17	502
PREVENTIVË NGA DHUNA NDAJ TË RINJVE	9	225
PREVENTIVË NGA TUBERKULOZI	11	256
MBROJTJE PËR DHËMBËT	9	180
PROMOVIMI I SHPREHIVE TË SHËNDOSHA PËR JETËN	22	744
PREVENTIVË NGA KANCERI	4	76
PREVENTIVË NGA SËMUNDJA E ENËVE TË GJAKUT	4	124
PREVENTIVË NGA PEDOFILIA	6	110
GJITHSEJ	494	13 090

Në gjithsej 494 punëtori edukative janë përfshirë 13090 pjesëmarrës.



FALËNDERIM PËR VULLNETARËT, ANËTARËT E ORGANIZATËS, PARTNERËT DHE DONATORËT

Falënderim të posaçëm për:

- Federatën ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe;
- Komitetin ndërkombëtar të Kryqit të kuq;
- Kryqin e kuq të Gjermanisë;
- Kryqin e kuq të Baden Vürtemberg;
- Gjysmëhënën e kuqe të Turqisë;
- Kryqin e kuq të Austrisë;
- Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
- Ambasadën e Francës;
- Ministrinë e mbrojtjes;
- Ministrinë e punës dhe politikës sociale;
- Ministrinë e shëndetësisë;
- Ministria e ekonomisë;
- Ministrinë e punëve të brendshme;
- Ministrinë e arsimit dhe shkencës;
- Qendrën për menaxhim me kriza;
- Drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim;
- Bashkësinë e njësisive të vetqeverisjes lokale;
- Entin për mbrojtje sociale;
- SZO – Shkup;
- Fondin global;
- UNHCR;
- UNFPA;
- OJQ Rubikon;
- HERA;
- Odën ekonomike të Amerikës;
- Oda ekonomike e Maqedonisë;
- Lidhja e odave ekonomike të Maqedonisë;
- Oda ekonomike e Maqedonisë veriperëndimore;
- SHA Posta e Maqedonisë;
- ERA Panairi i Shkupit;
- ONE;
- Operatorin VIP;
- Fondacionin T-Mobile për Maqedoni;
- Banka Komerciale SHA Shkup;
- ALFA Banka SHA Shkup;
- UNIQA – Austri;
- Stopanska Banka SHA Shkup;
- EVN Maqedoni SHA;
- Sigurimi SAVA SHA Shkup;
- SHA OKTA – Shkup;
- Studio Moderna;
- Alijans Uan – Maqedoni;
- Komfi Angel;
- Vinçini;
- KNAUF;
- FERSHPED SHA Shkup;
- Spitali special “Filipi i dytë”;
- ALKALOID SHA Shkup;
- EVROPA 92;
- Geneks;

RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2014

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë punën e vet e paraqet nëpërmjet raportit financiar i cili i përmban të hyrat dhe të dalurat e planifikuara dhe të realizuara. Raporti financiar paraqet vërtetim për aktivitetet programore dhe projektuese të implementuara me sukses të përkrahura nga partnerë vendor dhe të jashtëm të organizatës.

Puna e organizatës e paraqitur nëpërmjet të dhënave financiare paraqet vit të mbaruar me sukses me realizimin e Buxhetit prej 199.24% për dallim nga viti 2013 kur realizimi ishte 136.07%. të hyra personale janë realizuar me 122.41% dhe përafërsisht janë të njëjta si në vitin 2013 dhe marini pjesë me 25.02% nga të hyrat e përgjithshme të realizuara. Të hyrat nga organet dhe donatorët, paraqesin të hyra dedikuese, të cilat në pjesë më të madhe drejtpërsëdrejti transferohen në organizatat komunale, ku përdoren për implementimin e aktiviteteve projektuese. Këto të hyra janë realizuar me 252.03% shënojnë rritje në krahasim me vitin 2013 ku janë realizuar 138.92% si rezultat i aksionit të realizuar për sigurimin e përkrahjes financiare për popullatën që pësuan në përmbytjet në Republikën e Serbisë dhe në Republikën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Të njëjtat përfshijnë 74.98% nga të hyrat e përgjithshme të realizuara në vitin 2014.

Në pjesën e të hyrave mund të vërtetohet se shpënsimi është i kontrolluar dhe me qëllim, që është qëllim i secilës organizatë. Nga të dalurat e përgjithshme të realizuara, shpënsimet funksionale gjegjësisht programore shënojnë rritje në krahasim me vitin e kaluar dhe janë 76.77%, të dalurat për rroga për të punësuarit janë 9.28%, ndërsa shpënsimet materiale janë 13.95%. nga të dalurat e përgjithshme të realizuara 23.39% kanë të bëjnë për nevojat e qendrës dhe shënojnë ulje në krahasim me vitin e kaluar. 32.21% janë të transferuara drejtpërsëdrejti në organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe të njëjtat shënojnë ulje në krahasim me vitin e kaluar si rezultat i të dalurave të ulura në bazë të dhurimit të gjakut, përderisa të tjerat 44.4% janë mjete të cilat janë shpënsuar në zyrën qendrore e që kanë të bëjnë për realizimin e aktiviteteve programore të organizatave komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit.

Pjesë e tepërisë të mjeteve financiare gjegjësisht dallimi pozitiv mes të hyrave dhe të dalurave janë mjete qëllimore që kanë të bëjnë me projektin realizimi i së cilit vazhdon në vitin 2015.

Nga ana e Këshillit ekzekutiv të Kryqit të kuq të RM-së u formua komision, i cili realizoi revizion të brendshëm të punës financiare dhe materiale. Gjithashtu u angazhua shtëpi revizore e jashtme, e cila bëri revizion në pajtueshmëri me Ligjin për revizion dhe Standardet ndërkombëtare për lajmërim financiar dhe dispozitat kontabiliste të cilat vlejné në Republikën e Maqedonisë. Sipas mendimit të shtëpisë revizore, gjendja financiare e organizatës së Kryqit të kuq të RM-së është paraqitur në mënyrë reale dhe objektive.

Raporti financiar ka të bëjë vetëm me punën e zyrës qendrore të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.



RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2014

KRYQI I KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

01.01.2014-31.12.2014

	Buxheti 2014	Realizuar në vitin 2014	%	% në 2013
TË HYRA TË PËRGJITHSHME	43,353,105.00	86,378,756.00	199.24	136.07
Burime personale të të hyrave	17,655,100.00	21,612,425.00	122.41	129.66
Të hyra personale / nga donatorë	25,698,005.00	64,766,331.00	252.03	138.92
TË DALURA TË PËRGJITHSHME	43,353,105.00	77,429,582.00	178.60	120.99
Rroga dhe kompensime për të punësuarit	6,802,607.00	7,185,515.00	105.63	98.42
Të dalura për materiale dhe shërbime	9,373,082.00	10,801,363.00	115.24	141.93
Të dalura funksionale	27,177,416.00	59,442,704.00	218.72	120.74
DALLIMI	0.00	8,949,174.00		

TË DALURA

PËRSHKRIM	Burime personale të të hyrave	Të dalura nga organe / donatorë	"Buxheti 2014"	Realizuar nga burime personale	Realizuar nga organe / donatorë	"Realizuar 2014"
74 TRANSFERE DHE DONACIONE						
741 Ministria e punës dhe politikës sociale	6,000,000.00		6,000,000.00	6,500,000.00		6,500,000.00
741 Dhurimi i gjakut (Ministria e shëndetësisë)		6,763,000.00	6,763,000.00	6,020,000.00		6,020,000.00
742 Veprimtari sociale - humanitare	300,000.00		300,000.00	74,882.00	6,496,243.00	6,571,125.00
742 Organizim dhe zhvillim			0.00	18,931.00	702,632.00	777,514.00
742 Ndihma e parë	3,000,000.00		3,000,000.00	2,504,874.00		2,504,874.00
742 Edukim shëndetësor		5,735,005.00	5,735,005.00	0.00	5,813,946.00	5,813,946.00

742	Rinia	420,000.00		420,000.00	318,000.00		318,000.00
742	Katastrofa		300,000.00	300,000.00		730,933.00	730,933.00
742	Diseminim			0.00			0.00
742	KK në Aksion - PVH			0.00		12,188.00	12,188.00
742	Informim dhe komunikim			0.00			0.00
742	Shërbimi për kërkim			0.00		415,264.00	20,399.00
742	Njësia ndërkombëtare / Bashkëpunim ndërkombëtar		200,000.00	200,000.00		20,399.00	5,563,981.00
742	Mobilizimi i fondeve		2,500,000.00	2,500,000.00		5,563,981.00	0.00
742	Financa (të hyra tjera) kredit për veturë / ndalesa nga të punësuarit, kamata			0.00		77,388.00	77,388.00
72	TË HYRA PA TATIM						
725	Nga OKKK (në bazë të kotizimit)	1,500,000.00		1,500,000.00	1,357,284.00		1,357,284.00
725	Donacion nga persona fizik	200,000.00		200,000.00		12,787.00	12,787.00
725	Donacion nga persona juridik / Shitja e veturave	500,000.00		500,000.00			0.00
725	Pagesë shtesë për pulla (Nga ligji për KK)	300,000.00		300,000.00	225,351.00		225,351.00
723	Nga qiraja e pjesës afariste / të hyra tjera/ të hyra nga shitja e mjeteve kapitale	2,472,300.00		2,472,300.00	4,367,176.00		4,367,176.00
725	Nga regjistrimi i automjeteve	1,020,000.00	10,200,000.00	11,220,000.00		10,824,869.00	10,824,869.00
725	Të hyra tjera nga kamata / Fondi i solidaritetit / Fondi për zhvillim/ PVH	442,800.00		442,800.00	148,539.00	26,886,553.00	27,035,092.00
725	Të hyra të transferuara nga viti i kaluar	1,500,000.00		1,500,000.00		7,286,536.00	7,286,536.00
TË HYRA TË PËRGJITHSHME		17,655,100.00	25,698,005.00	43,353,105.00	21,612,425.00	64,766,331.00	86,378,756.00

TË DALURA

	PËRSHKRIM	Nga burime personale	Nga organe dhe donatorë	"Buxheti 2014"	Realizuar nga burime personale	Realizuar nga organe / donatorë	"Realizuar 2014"
401	RROGA ELEMNTARE DHE KOMPENSIME	5,865,323.00	887,284.00	6,752,607.00	7,100,011.00	0.00	7,100,011.00



402	KONTRIBUTE NGA RROGAT DHE TATIMI PERSONAL	50,000.00	0.00	50,000.00	80,420.00	5,084.00	85,504.00
	TË DALURA TË PËRGJITHSHME PËR RROGA	5,915,323.00	887,284.00	6,802,607.00	7,180,431.00	5,084.00	7,185,515.00
420	TË DALURA PËR RRUGË DHE MËDITJE	100,000.00	0.00	100,000.00	185,776.00	126,800.00	312,576.00
421	SHËRBIME KOMUNALE	975,000.00	0.00	975,000.00	1,349,941.00	36,744.00	1,386,685.00
422	NXEMJE	650,000.00	0.00	650,000.00	334,468.00	0.00	334,468.00
423	KOMUNIKIM DHE TRANSPORT	1,445,000.00	110,242.00	1,555,242.00	1,587,494.00	618,043.00	2,205,537.00
423	MATERIALE	1,571,000.00	1,763,152.00	3,334,152.00	2,471,534.00	1,847,841.00	4,319,375.00
424	MIRËMBAJTJE VIJUESE	808,000.00	0.00	808,000.00	1,485,783.00	2,829.00	1,488,612.00
425	SHËRBIME PËR MARRËVESHJE	5,714,082.00	3,742,578.00	9,456,660.00	3,300,153.00	6,391,181.00	9,691,334.00
426	TË DALURA TJERA OPERATIVE	400,000.00	0.00	400,000.00	1,048,337.00	23,773,486.00	24,821,823.00
463	TRANSFERE	0.00	18,761,444.00	18,761,444.00	0.00	24,941,647.00	24,941,647.00
	TË DALURA TË PËRGJITHSHME	17,578,405.00	25,264,700.00	42,743,105.00	18,943,917.00	57,743,655.00	76,687,572.00
	TË DALURA KAPITALE						
483	BLERJE E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE PËR ZYRA	60,000.00	0.00	60,000.00	305,562.00	136,023.00	441,585.00
483	BLERJE E AUTOMJETEVE	0.00	0.00	0.00	100,425.00	0.00	100,425.00
481	MIRËMBAJTJE ELEMENTARE DHE SPECIALE	450,000.00	0.00	450,000.00	200,000.00	0.00	200,000.00
	TË DALURA TË PËRGJITHSHME KAPITALE	510,000.00	0.00	510,000.00	605,987.00	136,023.00	742,010.00
	TË DALURA TË PËRGJITHSHME	18,088,405.00	25,264,700.00	43,253,105.00	19,549,904.00	57,879,678.00	77,429,582.00

Shërbimi financiar
Zhaklina Popoviq



Sekretar gjeneral
D-r Sait Saiti

		%
Transfere në OKKK	24,941,647.00	32.21
Shpenzime për qendrën	18,108,594.00	23.39
Shpensime nga qendra për OKKK	34,379,341.00	44.40
total	77,429,582.00	100.00

Të hyrat e përgjithshme të realizura në vitin 2014



Të dalura në vitin 2014



RAPORT I REVIZORIT TË PAVARUR

Ne realizuam revizion në raportet e paraqitura financiare të “KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË” (në tekstin e mëtejme Organizata), të cilat e kyçin Bilancin e gjendjes më 31 dhjetor 2014, si dhe Bilancin e të hyrave dhe të dalurave dhe Raportin për ndryshime në fondin afarist për vitin që mbaron atë ditë dhe shqyrtimin e politikave të rëndësishme kontabiliste dhe shënime tjera sqaruese. Raportet e paraqitura financiare për vitin 2014 përbëhen nga raportet për punë të rregullt të Organizatës si dhe raportet për projektet: 1) Fushata për HIV/SIDA; 2) Forumi SEE për adaptim në ndryshimet klimatike; 3) Fondi global për mbajtjen e prevalencës së ulët të HIV/SIDA në RM-së; 4) Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjymhënës së kuqe; 5) Kujdesi për personat e moshuar në bashkësi; 6) Intervencime DOTS në RM-së; 7) Promovimi i vlerave humane dhe raportet për dy fondet: 1. Fondi për zhvillim dhe 2. Fondi i solidaritetit, si dhe llogaria për donacione nëpërmjet rrugës elektronike. Projektet janë financuar nga donatorë të posaçëm dhe të njëjtat realizohen nëpërmjet nënlllogarive të posaçme (dedikuese) të Organizatës. Për ato Organizata nuk përgatit raporte të posaçme financiare.

Përgjegjësia e menaxhmentit për raportet financiare

Menaxhmenti i Organizatës është përgjegjës për përgatitje dhe prezantim objektiv të këtyre raporteve financiare në pajtuesmëri me Ligjin për kontabilitet të organizatave joprofitabile dhe standardet për lajmërim financiar në bazë të të hollave të gatshme. Kjo përgjegjësi kyç: vëllimin, implementimin dhe mbajtjen e kontrollit intern që është relevante për përgatitje dhe prezantim relevant të raporteve financiare të cilat janë të liruara nga paraqitja e gabueshme materiale, pa dallim se a janë rezultat i mashtrimit apo gabimit, zgjedhje dhe zbatim të politikave adekuate kontabiliste, si dhe kryerje të vlerësimeve kontabiliste të cilat janë të kapshme për rrethanat.

Përgjegjësia e revizorit

Përgjegjësia jonë është që të shprehim mendim për këto raporte financiare në bazë të revizionit tonë. Revizionin e zhvilluam në pajtuesmëri me Standardet ndërkombëtare për revizion. Ato standarde kërkojnë që t'i respektojmë kërkesat etike dhe ta planifikojmë dhe kryejmë revizionin që të fitojmë besim të kapshëm për atë se a janë të liruara raportet financiare nga paraqitja e gabueshme materiale.

Revizioni kyç zbatimin e procedurave për grumbullimin e dëshmimeve revizore për shumat dhe sqarimet në raportet financiare. Procedurat zgjedhore varen nga gjykimi i revizorit, duke kyçur edhe vlerësimin e rreziqeve nga paraqitja e gabueshme materiale të raporteve financiare, pa dallim se a janë rezultat i mashtrimit apo gabimit. Kur i bën ato vlerësime të rrezikut, revizori e shqyrton kontrollin intern relevant për përgatitje dhe prezantim objektiv të raporteve financiare që të formojë procedura revizore të cilat janë adekuate me rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së mendimit për efektivitetin e kontrollimit intern.

Revizioni gjithashtu kyç edhe notën e përshtatshmërisë së përdorimit të politikave kontabiliste dhe të të kuptuarit të vlerësimeve kontabiliste të bëra nga ana e menaxhmentit, si dhe notim të prezantimit të përgjithshëm të raporteve financiare.

Ne besojmë se dëshmitë revizore të cilat i kemi grumbulluar janë të kapshme dhe adekuate që të sigurojnë bazë për mendimin tonë revizor.

Mendimi i revizorit

Sipas mendimit tonë, raportet e paraqitura financiare të “KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË” e parqesin në mënyrë reale dhe objektive në të gjitha aspektet e rëndësishme, gjendja financiare e organizatës më 31 dhjetor 2014, si dhe rezultatet e punës së vet dhe ndryshimet në fondet për vitet të cilat mbarojnë atë ditë, në pajtuesmëri me Ligjin për kontabilitet të organizatave joprofitabile dhe standardet për lajmërim financiar në bazë të të hollave të gatshme.

Raport për kërkesa tjera juridike dhe rregullative

Menaxhmenti i Organizatës gjithashtu është përgjegjës për përgatitjen e raportit vjetor për punën në pajtuesmëri me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet. Përgjegjësia jonë në pajtuesmëri me Ligjin për revizion është që të lajmërojmë se a është konzistent raporti vjetor për punë me llogarinë vjetore dhe raportet vjetor për vitin që mbaron më 31 dhjetor 2014. Puna jonë në bazë të raportit vjetor për punë është kryer në pajtuesmëri me MSR 720 dhe është e kufizuar në paraqitje se a janë konzistent informacionet historike financiare në raportin vjetor për punë me llogarinë vjetore dhe raportet e reviduara financiare.

Raporti vjetor për punë është konzistent, në të gjitha aspektet materiale, me llogarinë vjetore dhe raportet e reviduara financiare të “KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË”, Shkup për vitin që mbaron më 31 dhjetor të vitit 2014.

Shkup, 03 mars 2014



Drejtuës
Dragan Dimitrov



Revizor i autorizuar
Zvonko Kočovski



ПУНКТ ЗА
ОБЛЕКА



WWW.REDCROSS.ORG.MK

 www.facebook.com/CrvenKrstNaRepublikaMakedonija

 www.youtube.com/MacedonianRedCross